




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e XIII (trembëdhjetë) të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më datë 30.12.2014 me këtë:

R E N D P U N E

- 1** Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar
- 2** Raporti i punës i kryetarit të Komunës për vitin 2014
- 3** Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoha komunale, 01. nr. 016-32277 e dt. 19.03.2014
- 4** Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës në Shërbimin Civil Komunal
- 5** Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve
- 6** Të ndryshme

Në punimet e seancës së XIII (trembëdhjetë) morën Pjesë:

Anëtarët e Kuvendit

Kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri

Drejtorët e drejtorive.

Përfaqësuesi i OSB-së, Irfan Ukshini

Përfaqësuesi i shoqërisë civile, Shaban Terziu

Zyrtarja për Barazi Gjinore, z. Dritë Klajiqi.

Përfaqësuesi i Njësisë për të Drejtat e Njeriut, z. Fazli Abdullahu

Përfaqësuesi i OJQ "Anamorava"z, Isa Shefkui

Zyrtari ligjor, H. Matoshi

Mediet

Seanca i filloi punimet në ora 10.10 min.

Seancën e trembëdhjetë (XIII) e hapi dhe udhëhoqi, kryesueseje Kuvendit, zonja Valentinë Bunjaku-Rexhepi e cila i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe kërkoi nga sekretaria që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në këtë seancë?

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar

Nga ana e sekretarisë i konstatua se në punimet e kësaj seance ishin të pranishëm; 32 anëtarë, kurse munguan tre: Bujar Nevzadi, Shukrie Rapuca, Imet Rrahmani

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – para se të fillojmë me punë po theksoj se ky Kuvend është me fat, sepse nga përbërja e këtij Kuvendit një anëtare e jonë Besë Baftiu ka shkuar deputete në Kuvendin e Kosovës, kurse z. Imet Rrahmani, është zgjedhur ministër i Shëndetësisë. Edhe zonjës Besë dhe z. Rrahmani në emër të juaj dhe të gjithë të pranishmëve tjerë i urojmë suksese në punë me dëshirë që ta përfaqësojnë Gjilanin në mënyrë dinjitoze.

Në vazhdim të punës së seancës, kryesuesja theksoi se materialin e keni marrë me kohë e cila edhe njëherë i lexoi pikat e rendit të punës dhe e hapi debatin për rendin e punës.

Sahit Abazi- së pari duhet konstatuar se materiali nuk na ka ardhur me kohë, sepse një material voluminoz siç është raporti i kryetarit është e pa mundur të analizohet për 1 ditë, por kjo është edhe thyerje e rregullave, sepse disa drejtori fare nuk kanë dërguar raport me shkrim. Gjithashtu ne njëherë jemi informuar se seanca do të mbahet një ditë pas mbledhjes së KPF-së e që më duket se kjo ka qenë e qëllimshme e të cilin qëllim ne nuk e kemi të qartë.

Sa i përket rendit të punës kërkoj që në këtë rend pune të inkorporohet edhe përkrahja e Hendikosit, për të cilin rast kemi debatuar edhe në KPF, kurse nesër është dita e fundit dhe Hendikosi është OJQ e cila i ndihmon njerëzit me aftësi të kufizuara, por më nuk kanë mjete për t' i vazhduar aktivitetet e tyre.

Kërkojmë që edhe çështja e Hendikosit të jetë si një pikë e rendit të punës nën të ndryshme dhe t' i ndahet kësaj organizate një shumë e mjeteve, sepse nëse ndodh mbyllja e Hendikosit do të kishte pasoja të rënda për këtë komunitet me aftësi të kufizuara.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- pika 5 e rendit të punës është për aprovim të Rregullores për subvencione dhe në këtë pikë do të kemi mundësi për ta shqyrtuar edhe çështjen e Hendikosit. Kjo pikë nuk është miratuar për Kuvend, por kryetari ka mundësinë dhe do ta ketë parasysh çështjen e Hendikosit.

Raporti i kryetarit iu ka ardhur me shkrim të premtën me në formë elektronike, kurse si kopje fizike iu ka ardhur pak më me vonë.

Fehmi Sylejmnai- edhe ne kemi vërejtje në shpërndarje të materialit, sepse kopjet fizike të raportit të kryetarit nuk janë dërguar me kohë dhe po shihet shumë qartë se kjo nuk është qeveri ekspeditive, sepse nuk i përmbahet rregullave. Sa i përket rendit të punës, unë mendoj se pikën 3 dhe 4 dhe 5 duhet shtyrë për një seancë tjetër, sepse nuk është mbajtur debat publik në veçanti për këto tri pikë, sepse Ligji për transparencë publike neni 7 në cilin nën theksohet se të gjitha rregulloret dhe vendimet i nënshtrohen diskutimit publik para takimit. Mandej nuk kemi për këtë as një njoftim në faqen e Komunës dhe nuk kemi asnjë të dhënë se çka është evidentuar para publikut kur është prezantuar ky diskutim dhe cilat janë marrë ato rekomandime të cilat janë marrë gjatë diskutimit. Gjithashtu na mungon edhe Rregullorja aktuale e cila është në fuqi, prandaj kërkoj që këto dy pikë të shtyhen për ndonjë mbledhje tjetër dhe të përpunohen më mirë nga stafi i juaj.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- rregulloret janë në ueb faqe të Komunës dhe gjithashtu për këto rregullore është mbajtur debat, por ka qenë desh të jeni të interesuar dhe të merrni pjesë në debat.

Fehmi Sylejmnai- nuk është mbajtur debat, por është mbajtur një debat pa njoftim publik, sepse në ueb faqe të Komunës nuk figuron askund që është mbajtur debat publik. Ne i kemi rregulloret aktuale dhe jo propozim rregulloret dhe dëshirojmë që t' i shohim ndryshimet se ku po bëhen, sepse kështu nuk po vërejmë ku janë ato ndryshime?

Riad Rashiti- sa i përket rendit të punës edhe unë kam vërejtje, sepse materiali nuk na ka ardhur me kohë, për shkak se 7 ditë para seancës materialin duhet ta marrim.

Në seancën e kaluar jemi marrë vesh që në seancën e radhës të futen edhe dy pika e të cilat kanë qenë në rend të ditës në seancën e kaluar si : Ndërtimet pa leje dhe pika tjetër Investime kapitale në Komunë, mirëpo ju edhe në këtë seancë nuk i keni propozuar? Po vërehet se ka tendencë për t' ikur problemeve dhe debateve më të mëdha për çështjet kryesore në Komunë të Gjilanit.

Gjithashtu raporti që është dërguar nga kryetari i Komunës, shihet se është një raport nëntë mujor dhe në asnjë rregullore nuk parashihet që kryetari të ketë raport nëntë mujor, sepse duhet të jetë raporti 6 mujor ose një vjeçar.

Po ashtu jam i obliguar që ta ngris shqetësimin tim edhe sot për refuzimin e kërkesave të cilat po bëhen nga institucionet komunale, duke filluar nga kryetari i Komunës i cili kërkesave për qasje në dokumente zyrtare nuk iu është përgjigj. Ne nga kryetari i Komunës kemi marrë një përgjigje se nuk mund t' i përgjigjemi disa kërkesave, sepse ato janë në hetime! Mirëpo kjo plotësisht është e pavërtetë dhe nuk qëndron, sepse ne kemi bërë kërkesë dhe kemi bërë pyetje pse nuk është botuar Monografia e Komunës së Gjilanit për të cilën monografi dy vite ka punuar një komision profesional i përfshirë nga të gjitha partitë politike. Për këtë Monografi është shpall tenderi është fituar dhuruesi nga Telcomi i Kosovës, por ajo nuk është shtypur? Kemi kërkuar qasje në dokumentacion për përbërjen e Këshillit të ekspertëve të cilin vendim e ka marrë kryetari i Komunës, por nuk kemi qasje. Informatë kemi kërkuar disa herë për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet për të cilin rast ekziston një raport prej 1.6 milion €, por nuk kemi përgjigje asnjëherë? Atëherë shtrohet pyetja a është edhe ky raport nën hetime? Ne nuk kemi kërkuar informacione për burimin e financimit të projekteve në Komunë të Gjilanit dhe jam i sigurt se 32 projekte nuk janë nën hetime dhe arsyet e kryetarit nuk janë të vërteta dhe janë të papërgjegjshme, joserioze dhe të pavërteta? Nuk mund ta mashtroni opinionin me këso deklarata të papërgjegjshme , prandaj kryetari më mirë është të thotë, unë nuk rri në Gjilan, nuk punoj në Gjilan, jam kryetar me korrespondencë dhe nuk kam kohë t' i përgjigjem kërkesave. Unë më tepër jam orientuar në Drejtori për Buxhet dhe Financa dhe në Zyrë të Prokurimit dhe i kam kërkuar disa përgjigje dhe nuk kam marrë përgjigje dhe kjo është fshehje e dokumenteve dhe të dhënave zyrtare? Gjatë këtij vitit në Komunën e Gjilanit janë anuluar 4 tenderë nga OSHP, prandaj ne duhet ta kemi një përgjigje me shkrim pse janë anuluar këta tenderë në vlerë prej 3 milion e 400 mijë €?

Gjithashtu edhe në muajt e fundit janë dhënë 18 tender dhe 14 prej tyre janë dhënë pa procedurë të hapur, prandaj është mirë të dimë pse kanë ndodhur këto gjëra? Po ashtu gjatë tërë vitit kompanitë jashtë Komunës së Gjilanit po marrin tender në Gjilan, sepse për këtë vit 18 tender janë dhënë jashtë Komunës së Gjilanit e të cilën listë e kam dhe të cilën edhe po e lexoj e që kanë vlerën 1 milion e 23 mijë €. Të harxhohen mbi 1 milion €, për kompanitë jashtë Gjilanit për punët që po i kryejnë në Gjilan, për neve është e papranueshme? Në Gjilan ka kompani sa të duam, sidomos janë gjashtë tender të cilat janë dhënë me procedurë të kuotimit, prandaj nuk është mirë që ky buxhet të shpenzohet në këtë mënyrë. Ne kemi kërkuar informatë për 55 objekte pa leje që po ndërtohen në Komunë të Gjilanit, kurse kryetari e thotë se këto objekte kanë filluar më herët, por kjo nuk është e vërtetë, sepse këto objekte kanë filluar këtë vit! Në fund e kërkoj një informatë se sa qytetarë e kanë lëshuar Komunën e Gjilanit? Pyetje tjetër është a keni vendos për ta qeverisur Gjilanin apo jo ? Mandej ku e keni në plan për ta bërë reformatimin e Qeverisë Komunale për të cilin reformatim keni dhënë deklarata plotë gjashtë muaj, por kjo nuk ka ndodhur. Sot kemi drejtori pa drejtorë, sektor pa shefa etj.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- të deklaroheni se kush është për aprovim të rendit të punës?

Aprovohet rendi i punës me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, 4 ishin kundër, kurse të tjerat ishin abstenime?

Procesverbali-

Fehmi Sylejmnai-f. 17 duhet të jetë:” Komisioni intervistues ka qenë i paligjshëm dhe janë shkelur dispozitat ligjore” dhe jo ka bërë shkelje të mëdha!

Nevzad Isufi- unë e kam një vërejtje e cila vërejtje duhet të vlejë për të gjitha procesverbalet, sepse përmirësimet në procesverbalet vijuese nuk bëhen dhe mbetën në versionin e parë. Unë mendoj se korrigjimet duhet të bëhen për të gjitha procesverbalet.

Aprovohet procesverbali nga të gjithë anëtarët e Kuvendit me këto vërejtje

2. Raporti i kryetarit të Komunës për vitin 2014

Lutfi Haziri- fillimisht kryetari i përshëndeti anëtarët e Kuvendit dhe të gjithë të pranishmit e tjerë dhe theksoi se sot jam i nderuar që para jush të kem mundësi të flas këtë fundvit duke e rekapitulluar angazhimin njëvjeçar të punës sonë të përbashkët në realizmin e objektivave të Komunës së Gjilanit.

Deri tani kemi shlyer 2 milion euro borxhe dhe do të vazhdojmë ti shlyejmë edhe borxhet tjera. Jemi duke punuar për kthimin e donatorëve të huaj, në mënyrë që të zhvillohet ekonomia dhe të përfitojnë qytetarë. Kemi investime nga qeveria zvicerane kryesisht në ujëra, pastaj kemi partneritet me “Danida” e Danimarkës, me qeverinë suedeze, pastaj Gjilani ka përfituar dy projekte të Komisionit Europian për rregullimin e parkut në lagjen “Dardania” dhe atë për bashkëpunim ndërkufitar me Komunën e Çairit nga Maqedonia. Pagesa e tatimit në pronë, do të kthehet në investime në qytet e fshatra.

Atyre që punojnë tokën 100% do të shpërblehet me 50 mijë euro projekt. Këtë vit Gjilani ka thyer kufijtë buxhetor, 2.4 milion euro buxhet më shumë se viteve tjera. Do ti japim përparësi edhe banimit social, ku 7000 qytetarë iu kanë drejtuar zyrës time dhe drejtorive për probleme të banimit dhe punësimit.

Kemi platformë për zgjidhje problemeve të banimit. Përparësi do ti japim banimit social. Janë 120 familje që presin ndihmën tonë për renovim dhe ndërtim të shtëpive. Shtëpitë e para kanë filluar të ndërtohen. Kemi shtëpi të pabanueshme, dhe do të bisedojmë me pronarët e tyre që ti japin me qira për qytetarët e pastrehë.

Në PPP ka banesa për shitje. Do të punojmë për përmirësimin e infrastrukturës. Ndërtimin e rrugëve në qytet dhe fshatra, mirëpo sfida është buxheti i pamjaftueshëm. Gjatë vitit të ardhshëm do të punohet në hyrje-daljet e Gjilanit. Po edhe autostrada Prishtinë-Gjilan dhe Gjilan-Ferizaj. Do të punohet në ujërat e zeza, ujërat atmosferike, dhe zgjidhja është bërë me hapjen e korridorit të Lumit Baja. Do të përfitojmë edhe ndërtimin e impiantit.

Kthimi i mendjes së Prishtinës dhe Tiranës ndaj Gjilanit. Në bujqësi për vitin e ardhshëm janë ndarë 1.2 milion euro. Do të subvencionohen familjet që duan të merren me bujqësi. Edhe vitin e ardhshëm do të ketë dietë buxhetore, shpenzime në minimum.

Raportet e drejtorive në mënyrë detale të gjithë anëtarët e Kuvendit i posedojnë me shkrim.

Avdyl Aliu- me të vërtetë tash e një vit që po punojmë bashkë si Kuvend mund të them se kemi qenë një Kuvend i dobishëm, sepse ka pasur shumë raste të urimeve për të arriturat nga kolegët tanë këtu.

U përmend tash më se deputetja (Besë Baftiu) dhe ministri (Imet Rrahmani) nga Gjilani, prandaj më lejon që në emër të juaj t' i shprehim falënderime ministrit Imet falënderime për punën e përbashkët të cilën e kemi bërë për këta muaj të cilën e kemi bërë së bashku, njëkohësisht i urojmë suksese në të ardhmen duke dëshiruar që puna e tij do të sjell rezultate të mira dhe dot ë rezultojë me punë të mira për Gjilanin.

Në këtë aspekt e kam edhe një urim dhe në emër të juaj i uroj kolegut tonë Arben Maliqit titullin e doktorit të shkencave sportive. Dëshirojmë që kjo nuk do të jetë porta e fundit të cilën e ka hapur Arbeni në drejtim të ngritjes profesionale.

Patjetër duhet t' i shprehim mirënjohje edhe kryetarit të Komunës për angazhimet e fundit të cilat i ka pasur dhe rolin që e ka luajtur në konstituimin e qeverisë së Kosovës, por duke dëshiruar që ta inkurajojmë për ta bërë punën e vetë të cilën e dinë për ta bërë dhe për ta marrë hisen tonë si Komunë të cilën e kemi.

Në lidhje me raportin tash një vit LDK dhe kryetari Haziri e morëm mbështetjen e qytetarëve të Komunës së Gjilanit, jo thjeshtë sa për ta harxhuar një mandat njëvjeçar, por për ta udhëheq Komunën e Gjilanit, rrugën e zhvillimit, mirëqenies së qytetarëve. Themeli i këtij zhvillimi dhe mirëbesimi është mirëqeverisja, kurse për mirëqeverisje kushti numër një është transparenca. Ka shumë vite të një zhgënjimi moral, ekonomik dhe social e të cilat as kryetari Haziri nuk do të mund t' i zhbëjë ato në mirëqenie dhe zhvillim për një kohë shumë të shkurtër. Duhet të jemi të vetëdijshëm se për t' i arrit objektivat tona na duhet një kohë e gjatë. Të gjitha punët që janë bërë dhe po bëhen është si rrjedhojë e një planifikimi të mirë, sepse raporti i kryetarit synon të nxis një vështrim kritik të asamblistëve, qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit. Ky raport në këtë mënyrë duke vendos një komunikim do të prodhojë edhe rritje të performancës. Pas këtij raporti të kryetarit dhe në përgjithësi pas seancës, besojmë se do të kemi edhe kritika, vërejtje, sugjerime, sepse ka pasur mundësi të bëhet edhe më mirë se sa është bërë ! Gjatë këtij nëntë mujori shumë mund dhe shumë kohë është harxhuar për të riparuar defektet që i kemi trashëguar fatkeqësisht nga e kaluara. Këto defekte do të na shërbejnë si një libër shkollor nga i cili dom të mësojmë se si nuk duhet punuar dhe si nuk duhet qeverisur!

Emëruesi i përbashkët i këtyre ndryshimeve pozitive dhe i këtij progresi nëpër secilën drejtori është shumë prej 2 milion €, të qeverisura mirë nga ekipi i kryetarit Haziri, sepse me ato borxhe është bërë edhe shlyerja e borxheve ndaj operatorëve ekonomik, të cilët operatorë i kemi gjet në një gjendje shumë të rëndë e të cilët i kemi shpëtuar nga bankrotimi dhe falimentimi. Nuk është se është bërë më e mira e mundshmja, ka mundësi edhe më mirë, por e mira nuk ka fund, por ne jemi të përkushtuar për më të mirën. Besoj se tash kjo do të ndodh me riorganizimin e Komunës të cilit riorganizim ia kemi hapur ne rrugën këtu duke votuar ndryshimet statutare dhe duke ia lënë mundësinë kryetarit për veprim.

Në emër të grupit kuvendar të LDK-së e vlerësojmë lartë qëllimin e mirë të kryetarit i cili ka raportuar drejtë dhe realisht dhe të njëjtën kohë e inkurajojmë kryetarin dhe ekipin e tij që të vazhdojë edhe më mirë, sepse ka mundësi për të bërë më shumë edhe më mirë. Ne si grup kuvendar i LDK-së do ta votojmë raportin e kryetarit, gjegjësisht raportin 9 mujor.

Sahit Abazi- sot ne e kemi një raport të cilin nuk mund ta quajmë raport, por për këtë njoftim që nuk mund ta quajmë raport unë do të filloj nga ato që i konsiderojmë vlera pozitive gjatë qeverisjes njëvjeçare. Është pozitive ulja e shpenzimeve të reprezentacionit, mandej ishte pozitive edhe Gala mbrëmja, sepse ka një lëvizje të solidaritet me ata që kanë nevojë për banim. Mund ta konsiderojmë edhe pozitive vazhdimin e projekteve të qeverisjes paraprahe, sepse shumica prej tyre janë në vazhdim e sipër. Ishte pozitive edhe shënimi i përvjetorit të Masakrës së Gjilanit, por për këtë manifestim unë e kam një vështrim personal. Ky përvjetor normalisht i ka vlerat e veta, por për mua do të ishte më mirë sikur ta bënim një përpjekje që këto shënime të datave kaq të rëndësishme do të ishte mirë që të ndërkombehtarizohen dhe të marrin përmasa më të mëdha.

Tani më lejon që t' i paraqesim edhe disa anë negative, sepse normalisht që dallojnë shkollat politike në ndërtim të institucioneve PDK- dhe LDK. Është vlerësim i ynë që e konsiderojmë si defekt serioz

mungesën e një plani ekonomik të Komunës së Gjilanit. Kaloj një vit qeverisje, por Komuna nuk ka plan për zhvillim dhe kryetari asnjëherë nuk e ka përmend ndonjë plan për zhvillim ekonomik. Kjo është arsyeje e ikjes së banorëve nga Gjilani, por ky është edhe problem i Kosovës, por neve na intereson Gjilani. Kjo është një dukuri jo aq për shkaqe ekonomike, por më tepër është se popullata nuk sheh asnjë perspektivë për të ardhmen. E lusim kryetarin e Komunës që së paku për vitin 2015 ta propozojë një plan ekonomik të cilin edhe ne si këshilltarë dhe shoqëria civile të japin kontributin dhe të ketë mundësi që ai plan të realizohet. Në këtë pikë ne mendojmë se është një dështim serioz, sepse nuk e dimë se kah do të orientohet Gjilani dhe cili është pozicioni i Gjilanit. Po shihet se e kemi një mungesë mjaft serioze. Kemi një vetëqeverisje e cila për fat të keq është përcjell me një dominim nga qentë endacak në Gjilan, por ka qenë edhe një fat që nuk ka pasur pasojë ende asnjë qytetarë. Mirëpo edhe pse nuk ka pasur rast tragjik, ka ndodhur frika, sepse fëmijët në mëngjes shkojnë në shkollë, por edhe kur dalin nga shkolla lëvizin me frik nga qentë endacak.

Një defekt tjetër shumë serioz është ndërtimet pa leje, sepse është një numër i madh i objekteve të ndërtuara pa leje. Nuk ka asnjë mbështetje serioze për rininë dhe fshatin, mbështetje serioze, nuk ka asnjë plan për rini, asnjë strategji. U përmenden tenderët dhe ishte një premtim i madh i kryetarit se do të punohet me kompanitë e Gjilanit. Nuk pamë asnjë mbështetje serioze për investime në fshatra, asnjë plan dhe asnjë strategji në këtë drejtim. U përmenden tenderët për të cilët është dhënë premtim se do të punohet me kompanitë e Gjilanit, por ka ndodhur e kundërta, sepse shumicën e tenderëve i kanë fituar kompanitë jashtë Komunës së Gjilanit. Shumicën e kohës kryetari e kalon në Prishtinë, por ka edhe shumë vizita jashtë shtetit të cilat dhe shumicën e kohës së punës kryetari e kalon jashtë Komunës së Gjilanit. Është çështja e punësimeve në Komunë, fatkeqësisht është kryekëput politike dhe asnjë punësim në Gjilan nuk ka ndodhur në bazë të ndonjë strategjie profesionale, sepse meritokracia në Gjilan vazhdon të jetë dominante. Nuk është mirë fare të shpallni konkurse dhe mos shpenzoni para për konkurse, sepse nuk respektohen fare.

Kishte një premtim të madh nga ana e kryetarit që kontratat në vepër nuk janë zgjidhje për Gjilanin, por Gjilani është në mesin e komunave që ka punësuar më së tepërmi punëtorë me kontratë në vepër. Mirëpo edhe te kontrata në vepër ka punësime në tërësi politike. Ne në një seancë e patëm një debat korrekt lidhur me disa fëmijë të Dëshmorëve të cilët janë punësuar me kontratë në vepër dhe ju e premtuat se do ta gjeni një zgjidhje. Kryetari fillojë të punësojë punëtorë me kontratë në vepër, por këta fëmijë të dëshmorëve mbeten të papunësuar, por në disa raste edhe kur kanë konkurruar në ndonjë pozitë për vend të punës nuk janë thirr as në intervistë.

Ajo që më la përshtypje në diskutimin e kryetarit për çështje të Monografisë ishte një tendencë politike dhe kryetari tregoi që e ka ndërmend të bëjë Monografi politike. Ndërhyrja e kryetarit të Komunës në Monografi në të cilën kanë punuar ekspertët e fushave të ndryshme dhe në të cilën ekip janë përfaqësuar të gjitha partitë politike të thuhet po e stopojmë se nuk qenka bash mirë, unë po e perceptoj si një tentim për ta politizuar Monografinë. E përmendi kryetari, shpalljen e kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, qytetar Nderi, z. Ilir Meta, por kjo ka ndodhur pa procedurë dhe më mirë është që të mos kishte ndodhur kjo fare se sa të bëhet keq. Në këtë rasi janë shkelur të gjitha procedurat, kurse arsytimi që është dhënë edhe aty ka shkelje. Arsytimi i kryetarit se Ilir Meta ka qenë kryeministër në kohë të luftës nuk qëndron, sepse në kohë të luftës kryeministër ka qenë dikush tjetër (Pandeli Majko).

Nëse ka qenë dështë të shpallet qytetar Nderi kryetarin e Kuvendit Ilir Metën, atëherë është në rregull, por jo kontributin, sepse nëse duhet shpall dikush qytetar nderi për kontribut në luftë, atëherë ka qenë desh dikush tjetër të shpallet, por ende askush në Kosovë nuk e ka nderuar një njeri me vlera siç ishte z. Majko. Z. Majko pushtetin e asaj kohe e shfrytëzoi maksimalisht për vlerat kombëtare tonat të përbashkëta. Në fund po i shpreh perceptimet edhe të qytetarëve në kohë të fundit dhe shumë prej tyre iu kanë perceptuar si njeri i shpresës i ndryshimeve, por deri më tash nuk iu doli ashtu dhe dita ditës po zhgënjehen. Ato drejtori të cilat janë më mirë janë ato drejtori të cilat e kanë ruajtur performancën e drejtorive paraprake siç është Administrata. Gjithashtu edhe Drejtoria e Arsimit mund të vlerësohet më pozitive në sajë të ruajtjes së performancës së qeverisjes paraprake, me pak ndryshime, por edhe me

punën e drejtorit aktual. Mirëpo në arsim ka shumë problem dhe përveç atyre që janë probleme, ka pasur edhe ndërhyrje politike të kryetarit të cilat kanë ndodhur në arsim qoftë te zgjedhja e drejtorëve, me punësime me kontrata mbi vepër etj. E keni bërë një gabim politik, kur e keni heq kriterin që fëmijët të regjistrohen në klasë të parë në bazë të kompjuterit. Ju i hoqët kriteret e qeverisjes së kaluar, por e keni pasur një mundësi që ta shfrytëzoni një vendim të tillë të qeverisë paraprake i cili i ka shërbyer shumë mirë procesit edukativo-arsimor. Mund të lavdërohet Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe unë e pash një deklaratë të drejtorit, por duhet të na tregojë ku janë dallimet. Në këtë drejtori ne e kemi pasur një drejtor i cili njihet në Kosovë dhe disa herë është shpallur si drejtorët më të mirë sa i përket kadastrit.

Te të gjitha drejtorit gjendja është kështu, kurse te Prokurimi, vërehet një numër i madh i anulimeve të tenderëve dhe kjo për neve është shqetësuese. Gjithashtu është një numër i madh i kontratave nën 10 mijë € dhe këto raste nuk janë të këndshme për këtë zyrë. Mirëpo shpresojmë se gjatë vitit 2015 do të kemi përmirësime, planifikime për të mirë të qytetarëve.

Në fund të gjithë kolegëve iu uroj ndërrimin e moteve i cili do të ndodh nesër duke iu uruar shëndet të gjithë dhe punë sa më të frytshme.

Selami Xhemajli- fillimisht iu përshëndes të gjithëve, por edhe unë ministrit nga komuna e jonë, z. Imet Rrahmani i dëshiroj suksese në punë në udhëheqje të Ministrisë së Shëndetësisë, por edhe Arben Maliqit ia uroj titullin e doktorit të shkencave sportive.

Sa i përket raportit të punës së kryetarit të Komunës, unë në emër të anëtarëve të AAK-së do t' i përmendi vetëm disa elemente. Shlyerja e borxheve dhe përkushtimi për një mandat të ri qeverisës për zbatimin e projekteve duke krijuar një element të ri qeverisës duke i shlyer borxhet, por edhe duke i kushtua kujdes realizmit të projekteve. Tendencia e zvogëlimit të shpenzimeve të luksit si reprezentacioni, shpenzimet e derivateve janë treguar në të gjitha drejtoritë dhe kjo është një tendencë që të krijohet një kulturë e mirë për shfrytëzim të kujdesshëm të resurseve publike.

Ne si pjesë e koalicionit e çmojmë lartë angazhimin e drejtorive dhe të kryetarit, por edhe AAK me drejtoritë që udhëheq me drejtorët e saj kanë treguar një performancë të suksesshme, sidomos në Administratë Publike në të cilën drejtori, janë eliminuar radhët e gjata në kohën e pushimeve të qytetarëve nga bota e jashtme, mandej aplikimi i sistemit online, Gjilani është Komuna e parë në Kosovë e cila ka filluar me zbatim të këtij sistemi. Edhe Drejtoria për Shërbime Publike e ka mbuluar terrenin me shtrirje të rrjetit të ndriçimit publik, por ka realizuar dhe po vazhdon të realizojë shumë projekte të tjera. Është meritë e ekzekutivit që ka dhënë hapësirë të mjaftueshme që drejtoritë me të cilat ne udhëheqim të tregojnë një performancën mjaft të suksesshme në Komunën e Gjilanit. Këto janë elemente pozitive me të cilat e mbështesim raportin nëntë mujor të kryetarit.

Nevzad Isufi-Do të doja që të kisha rastin të flisja për të mirat dhe gjithë atë që është pozitive në këtë raport të vonuar të Kryetarit të komunës, siç u tha edhe nga parafoletësit është tejet i vonuar, por edhe si i vonuar ka një fillim tejet të çuditshëm, të ngarkuara me pasaktësi e përgjithësime.

Fillohet me borxhet e shlyera prej 2 milionësh (dhe vërejtja ime qëndron edhe më tutje në anonimitetin e borxhlive të Komunës, të cilëve ia paska shlyer borxhi), pra nuk përmendet borxhi i përgjithshëm i komunës, shuma e borxhit të mbetur fare dhe menjëherë kalohet te puna në kthimin e donatorëve të huaj (nënkupto këta donatorë paskan qenë njëherë në Kosovë por paskan shkuar e tash duhet t'i kthejmë). Pastaj kalohet investimet nga qeveria zvicerane në ujëra, partneriteti me Danidën e Danimarkës dhe qeverinë suedeze, pa shpjegime për çfarë partneriteti bëhet fjalë, pastaj përmenden dy projektet e Komisionit evropian, për të kaluar te premtimet për të ardhmen, për ata që punojnë tokën, për të kaluar te banimi social përsëri në kuptimin e së ardhmes, po citoj “do t'i japim përparësi banimit social” “do të punojmë në përmirësimin e infrastrukturës”, “do të subvencionohen familjet që merren me bujqësi” etj, Kryetar, kemi të bëjmë me raportin gjashtëmujor të punës suaj në krye të ekzekutivit dhe punës së kryer deri me tash dhe jo me planet për të ardhmen, prandaj këto frazat më shumë i ngjajnë kohës së fushatës parazgjedhore.

Mendoj që Kryetari para se gjithash është dashur të merret me një sintetizim të punës së tij dhe të gjitha drejtorive, me fokusim në atë që është planifikuar dhe në atë që është arritur brenda një viti e jo vetëm gjatë në gjashtëmujorin e parë. Pra, do të duhej të kishin një raport analitik, të shoqëruar me narracion, ku paraqiten vështirësitë, sukseset dhe rekomandimet.

Por meqë kemi kryekëput një raport të drejtorive të veçanta do të ndalem në disa çështje të raportimit të drejtorive të caktuara.

Te raporti i Drejtorisë së arsimit, meqë kemi një paraqitje tabelore të numrit të përgjithshëm të nxënësve, kemi një përzierje të tyre, p. sh. Thuhet numri i nxënësve shqiptarë dhe turq dhe numri i nxënësve serbë dhe romë, po kështu ndodhë edhe me nr.e institucioneve arsimore, serbe e rome. Më intereson ta dijmë me që keni specifikuar përkatësinë kombëtare, atëherë pse nuk keni precizuar edhe numrin e saktë të tyre sipas përkatësisë, apo në mungesë të qasjes në **institucionet** e arsimit në gjuhën serbe që nuk i përgjigjen sistemit të Arsimit të Republikës së Kosovës, e duke mos ditur numri e saktë të tyre keni dashur t'i përgjithësoni numrin e nxënësve?

Po kështu do të doja të dija si qëndron çështja e raportit dhe shpenzimeve për bartjen e 1002 nxënësve në relacione të ndryshme e shumta, e sidomos nëpër fshatra, por që nuk kemi as shumën totale shpenzimeve as ndonjë shpjegim apo vërejtje, pse mungon kjo e dhënë?

Te Drejtoria e zhvillimit ekonomik, duket se kemi një mbarështim të mirë të gjithë materialit, të planeve dhe projekteve të rëndësishme, për mendimin tim mbase nuk është dashur të futen projektet të cilat ende nuk janë as në fazën fillestare, si p.sh. ndërtimi i parkut të qytetit në Lagjen Dardania I, apo edhe kompleksi I shkollave të mesme, përmes partneritetit publiko- privat apo edhe ndonjë projekt tjetër.

Te raporti i punës së Drejtorisë për Urbanizëm dhe mbrojtje të Mjedisit, mendoj se këtë raport e bëjnë paksa konfuz disa gjëra, për faktin se diku flitet për raport 6 mujor, diku raport njëvjeçar e diku nëntë mujor, si p.sh. te shumta e pagesave nga lejet e ndërtimit për periudhën janar- shtator 2014, tabela nën a, kemi “Raporti nëntë mujor i punës për periudhën Janar- shtator 2014”, ndërsa në tabelën e dytë, pra te raporti Financiar i të hyrave dhe shpenzimeve të **D.U.M.M** gjatë vitit 2014, pra një pasqyrë vjetore. Mendoj se këtu kemi të bëjmë ose me një pasaktësi në emërtimin e tabelave, ose kemi të bëjmë me dështim në realizimin e asaj që është planifikuar në masën më të madhe.

Mendoj që kësaj drejtorie i mungon plotësisht raporti për gjysmën e dytë të emërtimit të saj , pra ai i mbrojtjes së Mjedisit. Me asgjë nuk na tregohet çka është ndërmarrë në mbrojtje të **mejdisit**. Nga statistikat e këtij raporti del se për 110 lejet e ndërtimit për 6 mujor (mungojnë krahasimet me vitin paraprak) kanë realizuar 46129.00€, që i bie se një leje ndërtimore ka kushtuar 419.35 €

Theksi i vënë te disa lëndë për leje ndërtimi të lartë për banim kolektiv që qenkan në **procedurë** e që po ndikuakan në të hyra, nuk mendoj se duhet të jetë aq shumë me rëndësi, sa do të ishte dashur t'i **ipet** rëndësi respektimit të kushteve të **ndërimit**, **hapsirave** të lira, dhe përgjithësisht kriterëve të standardizuara bashkëkohore të ndërtimit, nga se nga praktikat e deritashme ato fare pak janë respektuar ose janë shkelur në forma të ndryshme.

Një fakt **kurajues** është përgjigja në kërkesat për leje në afat sa më të shpejt të mundur, siç thuhet në raport, gjë që është për t'u përshëndetur.

Te ky raport, po përmenden edhe objektivat në të ardhmen, e pasi që raporti është 6 mujor e realisht ne kemi kaluar edhe **gjatëmujorin** tjetër, pavarësisht se për këtë nuk po raportohet, i bie që objektivat jo që nuk janë realizuar në periudhën e parë, nuk janë realizuar as në periudhën e dytë, pra mbesin objektiva për vitet e ardhshme, pra objektivat për vitin 2014 mbesin të parealizuar plotësisht.

Besoj se Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit është në dijen se këto shifra të këtij raporti lidhur me ndërtimet, nuk janë në proporcion apo më mirë të themi janë disproporcion me **ndëtimet** në teren, prandaj besoj se e kanë kuptuar mungesën e bashkëpunimit me Drejtorinë tashmë të shuar të **inseksionit**, e cila po të funksiononte si e sa duhet, përpos që do kishte **sjellur** të hyra më të mëdha në Drejtorinë e Urbanizmi e **Mbrojtjes** së Mjedisit , do të kishim edhe respektim të ligjit të ndërtimit, **respektim** të planeve të reviduara urbanistike etj, nga e cila do të kishin përfitime si **qyterët** ashtu edhe institucionet.

Tashmë zhbërja e kësaj Drejtorie është një fakt i kryer, pra fjala është për Drejtorinë e Inspeksionit, ndonëse ende zyrtarisht nuk kemi dëgjuar të jetë shkarkuar drejtori i saj, i cili në këtë Kuvend pati premtuar se do të zbatoj ligjin dhe do të ndal ndërtimet pa leje.

Për zhbërjen e kësaj drejtorie na tregon edhe ky raport, në të cilin nuk kemi as edhe një fjali të vetme për punën e tij gjatë këtij viti. Jo vetëm për inspeksionin e ndërtimit por as të sektorëve të tjerë të kësaj drejtorie, inspeksion të sanitarisë e ushqimit, të inspeksionit për zbatimin e ligjit kundër duhanit etj.

Te Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe pronë kemi mjaftë të dhëna për punën e tyre, kemi shifra, të cilat duken të jenë objektive, përmenden edhe **vështirësit** etj., përmenden edhe uzurpimet krejtësisht në fund, përmenden nr. prej 47 uzurpimeve të pronës publike dhe sipërfaqja prej 3875 metrash katrorë, përmenden procedurat e **udhehequra** ligjore dhe thuhet se kanë gjithë dokumentacionin e kompletuar, por unë mendoj se nuk është bërë sa duhet në këtë fushë, sepse ka shumë më tepër uzurpime, që me të madhe kanë ndodhur, në veçanati në kohën e pasluftës dhe sipërfaqe shumë më të mëdha se sa këto të shënuara në këtë raport dhe mungojnë të dhënat për pronat e rikthyera nëse mund të shprehemi ashtu.

Medoj se si Dejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim kanë paraqitur në mënyrë të thukët raportin e tyre, kurse Drejtoria e Bujqësisë ka paraqitur edhe datat edhe projektet me të gjitha shifrat financiare, kohën e fillimit dhe realizimit të tyre, që me pak kujdes mund të nxirren edhe të gjitha çmimet, qoftë të subvencioneve, qoftë për dëmet e bëra nga vërshimet etj.

Në raportin që ka të bëjë me Drejtorinë për kulturë, rini dhe sport, Drejtori që “de Jure” nuk ekziston më, por “de facto” ka paraqitur një raport, aktivitet e së cilës janë prezantuar edhe në një nga seancat e afërta të këtij Kuvendi, raporton ndër të tjera edhe për punëtorë të komunave të tjera si Artana dhe Parteshi, të cilët janë edhe më tutje në listat e pagave të punëtorëve të kulturës të komunës tonë, shtrohet pyetja pse ndodhë kjo, pasi që janë listë pagash a do të thotë se edhe paguhen. Këtij raporti i mungon paraqitja e punës së teatrit apo teatri nuk do të bëjë pjesë në **inticionet** e segment e kulturës?!

Te raporti i Qendrës së **mjekësisë familjare** dhe Qendrës për punë sociale e sidomos në këtë të parin, kemi një raport tejet të përgjithësuar që më shumë i referohet kompetencave që ka, se sa asaj që është bërë apo është dashur të bëhet, gjë që nuk mund të thuhet raportin për pjesën e raportit për punë sociale. Le të **ilustorjmë** me shembuj këtë raport: Vaksinimi; “është bërë vaksinimi sipas planifikimit të fëmijëve parashkollor dhe atyre shkollor; është filluar me vaksinim **kurndër** gripit sezonal, është bërë furnizimi i rregullt me vaksina në bazë të planifikimit vjetor” etj. Sipas këtij raporti për këtë drejtori, **ska** numra, **ska** shifra, vlera numerike përgjithësisht, pra në dukje sikur gjithëçka është në rregull, po këtë më së miri e dinë qytetarët tanë po t’i pyesni, prandaj ata janë **barametri** i punës sonë, e ata na thonë krejt diçka tjetër, si për raportet e e Qendrës së mjekësisë familjare ashtu edhe për punën e secilës drejtori.

Pra ajo që duket se i mungon shumë këtij raporti në tërësi është **vetkritika**. Ne e **dime** se shumica e drejtorive as që kanë pasur plane vjetore të punës, por edhe sikur t’i kishin pasur, shumë rrallë ndodhë, qoftë edhe kur është plani më i mirë, që **gjithëçka** e planifikuar të realizohet në tërësi, ndërsa në anën tjetër të gjithë e dimë se implikimet buxhetore diktojnë edhe punën e çdo drejtorie dhe gjithë stafit të saj e kështu edhe të komunës në përgjithësi.

Nga kjo që u tha më sipër del se nuk jemi edhe aq transparenca, ndonëse gjatë gjithë kohës është thënë se jemi transparent bazuar edhe në këtë raport vet fshehja problemeve, vështirësive, **mosgadishmëria** për t’u ballafaquar me to tregohet një mungesë e madhe në respektimin e transparencës. Kështu Kryetari, s’ka raport për Zyrën për Komunitete dhe Kthim, s’ka raport për Zyrën për Integritet evropiane, s’ka raport për Zyrën për të drejtat e Njeriut, s’ ka raport as për stafin e Zyrës së tij, që për nga numri në listë pagash, është po aq sa edhe stafi i ish kryetarit Mustafa. Për të gjitha këto s’ka transparencë as në kuvend as në paraqitjen e të dhënave në vebfaqen e Komunës, edhe atje gjen vetëm emrat e përgjegjësve kryesorë por asgjë më shumë. Nga Kryetari nuk kemi asnjë raport për konsultimet me publikun dhe propozimet e qytetarëve, nuk kemi pasur as në vebfaqe as në internet materialet përcjellës për konsultimet e buxhetit 2015, mungon transparenca në paraqitjen e qëllimeve të vizitave jashtë vendit dhe asaj çfarë kanë përfutur qytetarët e komunës së Gjilanit nga to. Tek vendimet e Kryetarit të komunës në faqen e internetit gjen

vetëm një vendim që ka të bëjë emërimin e bordit udhëheqës të njësisë për kulturë të muajit shtator, as edhe një vendim tjetër të kryetarit të tashëm të komunës. Të gjitha vendimet tjera janë të ish kryetarit të mëhershëm të komunës.

Ndërsa për broshurat për informim të qytetarëve për fusha me interes për ta, as që bëhet fjalë, as për shpenzimet dhe planifikimit të buxhetit të komunës, as për broshurat për taksat, tarifat dhe gjobat, as broshurat për qasje në dokumentet zyrtare e broshura tjera të nevojshme për informim të qytetarëve asnjë gjurmë. Të gjitha këto punë është dashur t'i kryej zyra për informim e kryetarit por ja që nuk janë kryer asnjë.

Mendoj se nga të gjithë qytetarët është pritur më shumë punë, duke u bazuar në përvojën e gjatë tuajën në politikë, madje edhe në përvojën e mëhershme si Kryetar komune, por ky raport pune nuk përmbush as për së afërmi këto pritje, prandaj kritikën e mirëfillta dhe në dobi dhe interes të të gjithë qytetarëve, besoj se duhet pranuar me zemërgjeri, pa tendencë, madje edhe kur vijnë nga opozita. Prandaj juve si Kryetar dhe gjithë menaxhmentit të komunës u mbetet shumë për të bërë në të ardhmen, ndërsa ne si Kuvend t'u përkrahim sa herë që keni nisma të qëlluara, siç janë ato të bamirësisë dhe krijimit të donacioneve për të ndërtuar shtëpi për të pastrehët, por natyrisht këto duhet të vijnë pas obligimeve që kemi marrë para qytetarëve edhe Ju si kryetar e edhe ne si Kuvend.

Zijadin Maliqi- unë raportit financiar më tepër do t' i qasem në aspektin financiar, sepse e tha edhe vetë kryetari i Komunës që viti 2014 në aspektin buxhetor ka qenë një vit shumë i rëndë i cili kualifikim është realitet. Këtë e dëshmojnë borxhet e mëdha të cilat janë gjet, përveç atyre obligimeve kontingjente me të cilat Komuna mund të ballafaqohet nga ditë në ditë, janë edhe borxhet e mëdha të cilat i kemi thënë se janë në vlerë prej 4 milion e 200 mijë €. Pastaj janë shkurtimet buxhetore të cilat janë bërë nga ana e Qeverisë së Kosovës në kategori tjera të shpenzimeve. Për shkak të rritjes së pagave në vitin 2014, sepse mjetet për rritje të pagave nuk janë paraparë për vitin 2014 dhe tash jemi dëshmitar se për vitin 2015 ka pasur një shkurtim buxhetor sidomos te mallrat dhe shërbimet dhe të komunalit.

Të gjitha këto elemente kanë ndikuar që të jetë një vit bukur i vështirë financiar, mirëpo sipas mendimit tim menaxhimi i mirë i buxhetit nga ana e kryetarit dhe stafit të tij, reduktimet në shumë kode buxhetore ku ka pasur mundësi të bëhen, ka bërë që përsëri Komuna e Gjilanit të punojë me sukses gjatë vitit 2014. Janë thënë këto gjëra edhe në raport, janë shlyer mbi 2 milion € borxhe, pastaj në bazë të pasqyrave që janë dhënë nga ana e drejtorive, shihet se pjesa dërmuese e drejtorive kanë punuar me suksese. Gjithashtu edhe në kategorinë për banim social është bërë një iniciativë e mirë dhe është në rrugë të mirë që bëhet një zgjidhje për familjet skamnore. Në fushën e bujqësisë, sidomos me subvencionim të bujqësisë kemi rezultate shumë të mira, por edhe në investime, sidomos në 4 prioritetë që janë thënë në asfaltimin e rrugëve, kanalizimit, ujësjellësit dhe në ndriçim publik në të cilat kategori kemi rezultate shumë të mira. Po thuaj se në të gjitha lokalitetet e Komunës së Gjilanit janë prekur me investime dhe janë në rrugë të mirë që ato të përfundojnë.

Një sukses shumë i madh i kryetarit dhe stafit të tij është rritja e dhuruesve (donatorëve) si të jashtëm ashtu dhe të brendshëm.

Nëse e ke buxhetin dhe merr donacione nga brenda është një aftësi, por nëse thith donacione nga jashtë, atëherë është në aftësi më e madhe. Kjo u pa edhe në bazë të paraqitjes së punës së kryetarit dhe është punë e cila duhet të paraqitet në raport, sepse donacionet janë siguruar, kurse puna bëhet në vijim.

Në bazë të gjitha këtyre që i thash për pa hyrë në detale mund të them se viti 2014 për mua është një vit i suksesshëm. U tha edhe nga kryetari se ka edhe mangësi, por gjatë vitit të ardhshëm do të angazhohemi që sukseset të jenë edhe më të mira.

Selvete Shurhdani- unë fillimisht e përgëzoj kryetarin për të gjitha punët të cilat janë realizuar për këtë nëntë muaj dhe shpresoj se të dhënat për një vit do të jenë edhe më transparente dhe më reale.

Gjithashtu e shfrytëzoj rastin në këtë seancë që ta përgëzoj dr. Imetin i cili i cili nga Komuna e Gjilanit do ta drejtoj Ministrinë e Shëndetësisë dhe mendoj se dr. Imeti do të jetë ministër me fat dhe do të

angazhohet për të bërë reforma shëndetësore të cilat reforma i ka hartuar ish ministri i Shëndetësisë Ferid Agani. Do ta bëjë një reformë e cila është ballafaquar me sfida dhe kundërshtime të mëdha, sepse është vlerësuar nga profesionistët e vendit dhe ndërkombëtar shumë pozitivisht.

Sigurisht implementimi dhe jetësimi i sigurimeve shëndetësore do t'ia heq popullatës një brengë shumë të madhe e cila mangësi i ka rënduar në shëndet. Më parë u tha se nga ky Kuvend, në Kuvendin e Kosovës si deputete ka shkuar edhe dr. Besë Baftiu, por nga ky Kuvend si deputete ka shkuar edhe drejtorja e Drejtorisë së Shëndetësisë zonja Labinotë Murtezi –Demi. Gjithashtu e përgëzojmë edhe Arben Maliqin për mbrojtje të doktoraturës së shkencave sportive.

Nën tre kisha thënë se shlyerja e borxhit dhe dieta buxhetore e cila është aplikuar këtë vit e ka bërë Komunën e Gjilanit të frymojë shumë më lirshëm. Ndërsa raporti i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale mungon pjesërisht.

Arben Maliqi- në këtë seancë po bëhen disa falënderime dhe me këtë po tregojmë një kulturë të lartë me përjashtime, por falënderime për të gjithë juve anëtarë të Kuvendit për urimet e sinqerta. Unë mund t'iu njoftoj se Komuna e Gjilanit e ka një privilegj, sepse i ka 9 doktorë të shkencave të sportit dhe është një prioritet i kryetarit të Komunës, por edhe i të gjithë që qytetarëve të Gjilanit, mandej Medvegjës, Bujanocit dhe Preshevës që në Universitetin e Gjilanit të hapet edhe Fakulteti i Kulturës Fizike.

Do t'iu them pak fjalë për raportin, sepse shumë gjëra u thanë, por u përmend borxhi dhe është bërë mirë që janë shlyer pjesa dërmuese, sepse borxhi dhe belaja nuk presin ditë të mira. Është mirë që kryetari i Komunës dhe ne së bashku pozitiv dhe opozitiv t'iu shlyejmë këto borxhe, t'iu kryejmë obligimet kompanive të cilat kompani kanë shumë punëtorë të krahut të cilët i mbajnë familjet e tyre. Për këtë arsyeje sa më parë duhet kryer obligimet ndaj këtyre kompanive.

Qasja ndaj qytetarëve, duhet të mundohemi që ta japim një kontribut që skamnorëve së paku t'iu sigurojmë një kulm mbi kokë. Bujqësia patjetër duhet të ketë prioritet duke i stimuluar në çdo mënyrë të gjithë ata njerëz të cilët e punojnë tokën. Mirëpo krahas praktikës, duhet ta kenë prioritet edhe Shkollën e Agrobiznesit dhe të mendojmë se çka do të bëjmë në të ardhmen. Duhet t'iu stimulojmë fëmijët tanë që të shkojnë në atë shkollë për të pasur rendimente më të larta në bujqësi.

Monografinë nuk e përmendi askush përveç shefit të grupit të PDK-së, unë po e them se Monografia duhet të rishikohet, sepse unë nuk po hyj në aspekte tjera përveç sportit, në të cilën fushë përveç një gazetari i cili ka punuar, aty nuk kanë marrë pjesë njerëzit profesional. Edhe atë ditë në teatër ka pasur moskuptime, ka pasur probleme, por unë them se Monografia duhet të rishikohet, por në mënyrën më të sinqertë në të gjitha aspektet.

Sa i përket sportit, kryetari ndoshta pak ka folur për sport, duhet të flasim dhe të bëjmë më shumë për sport, sepse me sport merret më së tepërmi rinia. Fëmijët tanë për t'iu larguar nga rruga dhe për t'iu siguruar një të ardhme më të mirë fëmijët patjetër duhet të merren me sport. Mirëpo për t'iu marrë me sport duhet t'iu sigurojmë një infrastrukturë sportive. Anëtarësimi i Komitetit Olimpik ia ka hapur rrugët të gjitha federatave tjera që të futen në familje evropiane dhe të bëhen ambasadorë tanë më të mirë të mundshëm. Mesazhi im për këtë vit është një vit i cili mendoj se do të jetë më i vështiri, por besoj se pasi që janë bërë bashkë dy parti më të mëdha jam bindur se do ta stabilizojnë gjendjen ashtu si duhet. Mesazhi im është që të gjithë deputet e Komunës së Gjilanit pa dallim përkatësie partiake që të punojnë në të mirën e Komunës sonë. Ministri i Shëndetësisë e ka marrë detyrën i urojmë suksese, por barrën më të madhe do ta ketë lideshipi i Anamoravës, z. Haziri.

Fehmi Sylejmani- Sipas LVL, neni 58, pika (j) thotë:kryetari raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomike-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës.

Dhe tashmë po mbaron një vit i plotë i kësaj qeverisje dhe që asnjëherë deri më tani, kryetari nuk ka raportuar para këtij kuvendi, derisa në këtë seancë thirret në gjashtëmujorin e parë. Një absurd i llojit të vetë.

Sidoqoftë një thënie e Aristotelit, filozof i njohur thotë: “Çdo vegël e kryen më së miri qëllimin e caktuar të saj, në qoftë se nuk shërben për shumë punë, por vetëm për një”

Me këtë thënie të famshme të Aristotelit po e paraqesim punën njëvjeçarë të kryetarit Haziri, që sipas neve, dhe me plotë të drejtë konsiderojmë, se ky kryetar më shumë është përkujdesur për subjektin e tij në qendër se sa për qytetarët e komunës së Gjilanit, të cilët ia kishin besuar udhëheqjen e komunës. Nuk janë të gjithë qytetarët e komunës anëtarë të LDK, edhe përkundër që votën ua kanë dhënë si kryetar. Madje jo vetëm që ka shërbyer për subjektin e tij, për 24 orë online, kryetari Haziri shumë shpesh ka kryer edhe rolin e ministri të punëve të jashtme, për faktin se ka pasur udhëtime të shpeshta jashtë vendit, por që fatkeqësisht nuk ka sjell ndonjë njohje ndërkombëtare e as ndonjë projekt zhvillimor.

z.Kryetar, sa herë Ju për këto udhëtime keni raportuar në këtë Kuvend apo në Komitetin për Politikë dhe Financa. Jeni të obliguar ta bënë këtë, por ja që nuk keni pasur kohë të mjaftueshme. Le të gjykojnë qytetarët gjilanas këtë veprim Tuajin.

Nuk do të jemi asses kritikë ndaj proceseve dhe zhvillimeve të mira e të mbara në komunë, por kur po e shohim se ka kaluar një vit nga udhëheqja e juaj z. Kryetar, nuk po shohim se ka progres, por përkundrazi kemi regres.

Keni premtuar se do të ketë zvogëlim të papunësisë dhe varfërisë, por realiteti është i kundërt me premtimin e juaj, sepse për keqardhje kemi rritje të lartë të papunësisë dhe varfërisë, e madje ditëve të fundit kemi edhe eksod të grupeve familjare, por edhe atyre të rinjve, në shenjë të pakënaqësisë së zhvillimeve ekonomike, politike, sociale në komunë e në tërë vendin.

Nuk janë vetëm këto dy çështje që i keni premtuar, por ne po ua përkujtojmë jo vetëm Juve, por edhe qytetarëve të komunës, se Ju keni premtuar edhe zgjerim të parkingjeve, largimin e kundërmimit të ujërave të zeza, zhvillim ekonomik, përfundimin e punimeve të lumit Mirusha, madje edhe atë në fund të shatorit të këtij viti që po e lëmë pas, mirëmbajtjen e duhur të ndërtesave të vjetra, mirëmbajtjen e duhur tregut të gjelbër, largimin e uzurpatorëve, uljen qind për qind të taksave komunale, shlyerjen e borxheve ndaj bizneseve.

Në vitin e parë të qeverisje suaj keni thënë se do t'i ndajmë një milion euro për bujqësi. Ku janë ato një milion, e ne jemi dëshmitar të së vërtetës, se Ju madje keni tërhequr mjete nga drejtoria e bujqësisë dhe keni dislokuar në një tjetër vijë buxhetore. Keni premtuar se do të bëni ndarjen falas të grurit për mbjellje, naftën dhe korren. z. Kryetar, a keni qenë të vetëdijshëm për këto premtime, sepse të gjithë qytetarët tashmë e dinë se asnjëra prej tyre nuk është realizuar.

Keni premtuar se për bujqit do të ofroni shitjen e produkteve bujqësore në fabrikën e miellit “Kualitetit” dhe në “Ask Food”, por a jeni Ju në dijeni se çka po ndodh në truallin e fabrikës së bukës, a keni ju njohuri se a ka ndonjë hapësirë të lirë për një gjë të tillë, si ide vërtetë ka qenë brilante. A jeni Ju të sigurt se fabrika e bukës do të vazhdojë këtë veprimtari, apo do t'i ndryshohet veprimtaria, mos vallë kjo fabrikë e bukës, e një rëndësie të veçantë, do të shndërrohet në ndonjë kompleks hotelerie. Ju sugjerojmë të keni një përkushtim më serioz ndaj kësaj çështje dhe kësaj hapësire.

Gjithashtu keni premtuar se 50 % e buxhetit të komunës do të shkojë për familjet që punojnë tokën. Deri më tani nuk kemi akoma asnjë familje fatlume me këtë benificion.

Keni premtuar se femrave do t'ua siguron shkollimin falas. Edhe këtu nuk kemi asnjë femër që ka pas këtë fat. Keni premtuar se do të rritet niveli i përfaqësimit të femrave në ekzekutiv. Qytetarët e komunës së Gjilanit, nuk po mund ta numërojnë të paktën një drejtoreshë të ndonjë drejtori të caktuar përkatëse. Keni premtuar se do të rritet niveli i pastërtisë së qytetit. Me keqardhje duhet potencuar se ka mbetur vetëm një fontanë dëshirash.

Keni premtuar rritjen e numrit të parqeve dhe kopshteve për fëmijë. Qytetarët e Gjilanit me kontributet e tyre edhe më tej po paguajnë qira të larta për dy çerdhe në qytet.

Keni premtuar se asnjë zonë nuk do të jetë pa ndriçim publik. Prindërit e shumë nxënësve të shkollave përkatëse në qytet, duhet lënë anash shumë punë të tyre jetësore, për t'i pritur fëmijët e tyre pas mbarimit të mësimi për t'i shoqëruar deri në shtëpi, për mungesë të ndriçimit publik, veçmas nxënësit e shkollave periferike.

Keni premtuar depolitizim të sistemit arsimor dhe administratës së komunës.

Edhe përkundër vullnetit të mirë dhe përpjekjeve personale të drejtorit të arsimit, që ky sektor të ecë në rrugë të mbarë, pikërisht interferimi i subjektit të Juaj e veçmas të disa personave, të cilët veten e konsiderojnë “të mëdhenj” e “të dijshtëm” kanë ndikuar që në këtë sektor të ndodhin disa skandale, që tashmë tërë opinionin gjilanas është në dijeni. Mos shpallja e vendeve të lira të punës, pranimi i kuadrit jo të kualifikuar dhe nepotizmi, Komisioni Intervistues për drejtor të politizuar dhe i paligjshëm, skandali për marre të ekskursionit të shkollës së mjekësisë e shumë shumë parregullsi tjera.

Ndërkohë çdo ditë e më shumë po i punësoni militantët e partisë së Juaj nëpër sektorë të ndryshëm të administratës së komunës, madje pa shpall fare konkurs, gjë që është në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Keni premtuar se të gjitha klubet sportive do të kenë buxhetin e ndarë vjetor.

z. kryetar, në mungesë të mjeteve materiale disa klube sportive, pikërisht gjatë mandatit të Juaj janë shuar, derisa shumë klube tjera janë në gjendje të mjerueshme për nga aspekti financiar.

Keni premtuar se në pjesën e dytë të vitit të parë të qeverisjes së Juaj, anëtarët e Kuvendit komunal do të pajisen me llap-top. Akoma një premtim të tillë nuk e keni realizuar.

Gjatë mandatit të Juaj, madje ende pa i mbushur një vit, shpërbetë dy drejtoritë më vitale të komunës, atë Inspeksionit dhe të Kulturës.

Në gjithë botën drejtorja për Inspeksion është një kujdestare dhe korrektore e qeverisjes, kjo te ne është shuar. A e dini pse?!, Sepse këtë qeverisje nuk duhet askush ta inspektojë, monitorojë dhe kontrollojë. Edhe këtë po e ilustron me një thënie të Aristotelit:

“Ligjet e mira nuk mund të krijojnë rregullim të mirë, në qoftë se nuk i nënshtrohen njerëzit”

A jeni në dijeni z. kryetar, se sa objekte ndërtimi, qoftë individual, qoftë kolektiv apo afarist janë duke u ndërtuar edhe atë pa asnjë dokument me të drejtë të punë. A mos vallë, për këtë shpërbetë drejtorinë e Inspeksionit?! Aferim!

A jeni në dijeni Ju z, kryetar, se edhe ato punë-projekte që janë kryer, me çfarë cilësia janë kryera, si janë realizuar, kush i ka kontrolluar apo mbikëqyrur dhe kush i ka pranuar?

Për të mos harruar opinionin gjilanas, kryetari Haziri që në nismë të punës së tij ka përmendur se ka trashëguar shumë borxhe, aq shumë sa e kalojnë shifrën e tetë milionë eurove, kanë gjetur 28 probleme madhore, mos-disiplinë buxhetore, mbingarkim të stafit e probleme të tjera që duan zgjidhje. Kryetari Haziri, ka thënë se ka pasur shumë probleme në punësim. „Gjetëm punëtorë të sigurisë në arsim e roje të pyjeve në shëndetësi“. „Nuk do të lejojmë që ekzekutivi të marrë ngjyrimë politike, ngase të emëruarit, drejtorë do të jenë vetëm për punëtorët e tyre, në drejtoritë ku ata do të udhëheqin e për mua do të jenë këshilltarë të mi, derisa për çdo gabim që bëjnë ata do të largohen“. Ku u tretën këto premtime z. kryetar? Kryetari Haziri po ashtu patë thënë, se Gjilani zhvillimin e vet e sheh edhe në investimet nga jashtë, në të cilat ka qenë i përjashtuar në vitet e kaluara. Për këtë qëllim, kreu i Gjilanit patë paralajmëruar se do ta emëroj një këshilltar të tijin të lartë për grande e investime e i cili do të ketë një rol të fuqishëm. Unë nuk e di, edhe pas një vit nëse ka ndonjë zyrtar për këtë çështje, që në letër është ide gjeniale.

Qeveria ose duhet t'i paguaj borxhet ose borxhin do ta paguaj vetë, sepse nuk ka hy me autoritetin e saj të ndal këtë trend, andaj ajo ka hy në obligime dhe është bashkëborxhli e Ministria e Financave është pjesë e barabartë në këto borxhe që janë krijuar në komunën e Gjilanit. Kështu patë deklaruar Haziri, në fillim të mandatit të tij. Z.kryetar, a mendoni edhe më tej, se qeveria duhet të jetë bashkëborxhli.

Po ashtu kryetari Haziri në fillim të mandatit të tij patë deklaruar se “do ta udhëheq komunën me lak në fyt, ngase borxhet që po i trashëgoj janë tetë milionë euro, andaj paralajmëroi një auditim të pavarur për të konstatuar ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e këtij konstatimi financiar.

Këtë komision të auditimit, tërë kohën z. kryetar, anëtarët e LVV në këtë kuvend e kanë kërkuar, por akoma nuk kemi një raport zyrtar rreth kësaj kërkesë dhe këtij paralajmërimi të Juaj.

Me plotë të drejtë në secilin cep të komunës, qytetarët pyesin dhe kërkojnë projekte reale e praktike, investime, zhvillim, punësim e jo retorikë boshe, sepse është lodhur qytetari më me këto fjali bajate dhe të demoduara. Qytetari di të vlerësojë saktë se çka është vlerë e çka nuk është vlerë. Nëse për dike është premtimi bosh, mashtrimi dhe gënjeshtria e kulluar vlerë, atëherë për qytetarët vlerë është puna praktike, reale dhe e prekshme, prosperiteti, mirëqenia dhe zhvillimi i komunës.

Dhe, nëse nisemi nga një fjalë popullore, se dita e mirë shihet në mëngjes, atëherë nga kjo qeveri aktuale në të ardhmen nuk presim ndonjë të arritur të theksuar, për shkak të përfomancës së dobët të dëshmuar deri më tani, si kundër që nuk ka shfaq shenja të mira, se ka vullnet të mirë politik, ka qasje të mirë, ka vizion, ka program, ka kuadro dhe thjeshtë ka menaxhment të mirë. Politikëbërjet në nivel lokal dhe atë qendror kanë dallime të mëdha dhe esenciale.

Fatbardhë Selmani- ju z. kryetar në raportin tuaj i keni përmend disa të arritura dhe disa sfida me të cilat jeni përballë gjatë këtij vitit në sektorin e shëndetësisë. Kërkoj për ta ditur pse nuk ka raport të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, por ka një ndarje të raportit të QKMF-së dhe një ndarje të thjeshtë të QPS-së. Pse nuk janë përfshirë të metat kryesore të qeverisjes së juaj, sepse 7 muaj nuk keni qenë të gatshëm nuk keni qenë të gatshëm të emëroni në krye të Drejtorisë për Shëndetësi një njeri posti i të cilit nuk do të shkaktonte konflikt interesi siç po shkaktonte tani emërimi i UD të kësaj drejtorie. Aktualisht një njeri i kryen dy detyra, një të UD të QKMF-së dhe drejtorit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Gjatë këtij viti nga keq menaxhimi i juaj shumë punkte nëpër fshatra nuk kanë funksionuar dhe në vazhdimësi keni pasur mungesë të stafit i cili fakt ka shkaktuar vështirësi në marrjen e shërbimeve shëndetësore. Kontrolli sistematik i nxënësve nuk është realizuar dhe pse në Komitet e kemi pasur një planifikim i cili është bërë nga QMF-ja, por nuk është shqyrtuar asnjëherë. Të hyrat kanë qenë për 31 mijë €, më pak se planifikimi. Në këtë nëntë muaj QKMF është përballuar me mungesën elementare të mjeteve të punës nga mos menaxhimi i mirë. Jam në dijeni se ka pasur raste që me muaj kanë munguar vaksinat. Gjithashtu për shkak të mungesës së subvencioneve dhe mos mbështetja financiare janë shuar shumë aktivitete sportive, aktivitete kulturore, sektorë të ndryshme të drejtorive, kurse tash në prag të shuarjes është edhe OJQ Hendikos e cila ka kërkuar subvencion 20 mijë e 900 €. Listën për subvencione e keni kërkuar, por nuk na është dorëzuar dhe këtu ka dyshime se edhe këtu ka shkelje.

Uji i pa pijshëm në shkollë dhe në Qendra të Mjekësisë Familjare ka rezultuar se është i papërdorshëm në disa fshatra, por që nga shtatori nuk kemi të dhëna se është marrë ndonjë hap konkret. Nga këto dhe shumë arsyeje të tjera rezulton fakti se ju e keni kthyer shëndetësinë e Gjilanit në vitet 2 mijë, kur ishim një vend i dal nga lufta dhe me shumë probleme. Sugjerojmë që në vitin tjetër të jeni më të përkushtuar sa i përket këtij sektorit të Shëndetësisë i cili është shumë të rëndësishëm.

Riad Rashiti- sa i përket raportit të kryetarit i cili është sjell si material është vetëm një faqe dhe kjo tregon jo seriozitetin e punës dhe angazhimit të kryetarit. Kryetari i Komunës gjatë tërë vitit asnjëherë nuk e ka respektuar KK-në dhe nuk ka qëndruar deri në fund të seancës. Sot është një raport me të cilin ne sot po krijojmë mundësi për të debatuar për punën e KK-së, por edhe këtu e kemi të kufizuar hapësirën për të bërë pyetje dhe marrë përgjigje, sepse koha është e kufizuar sipas Rregullores së Kuvendit, por e cila rregullore asnjëherë nuk është respektuar më parë.

Ne i bëmë disa pyetje, por përgjigjet është mirë të jenë më konkrete, sepse përgjigjet e tij më tepër ishin për punët që do të vijnë se sa që ka folur për punët, sukseset dhe të arriturat e qeverisjes së kryetarit Lutfi Haziri. Është mirë kryetari të na jep përgjigje për shumë probleme, prej të cilave unë do t' i bëj disa pyetje. Sot jemi më 30 dhjetor, kurse Komuna e Gjilanit i ka rrugët e pa pastruara, prandaj është mirë të na jep përgjigje pse po ndodh kjo dhe pse po lejohet që KK Komuna e Gjilanit sot të jetë me rrugë të tilla. Ka edhe disa punë të mira të cilat janë bërë gjatë këtij viti, por edhe ato janë të mangëta, por fal angazhimit të disa drejtorive mund të thuhet se kanë mbijetuar mirë siç është Administrata që ka punuar mirë, Bujqësia, Kadastrë, por në veçanti Drejtoria për Shërbime Publike e cila ka qenë e angazhuar dhe e përkushtuar për t' i kryer punët të cilat i përkasin kësaj drejtorie. Me një fjalë ka disa punë të mira, por në shumë sektorë ka ngecje dhe punë të pazgjidhura.

Do të ndërlihem te obligimet, sepse po thuhet se janë 2 milion € borxhe? Është mirë, z. kryetar që tash e tutje, sepse kaloj fushata, kaloj një vit i qeverisjes së juaj, prandaj është mirë që sot e tutje të jeni më konkret në ato që i deklaroni publikisht. Po thoni se janë 2 milion € borxhe që i keni shlyer? Çdo gjë është në rregull, mirëpo në bazë të Raportit financiar, Komuna e Gjilanit të hyra vetanake i ka pasur 3 milion €, kurse Raporti i Zyrës së Prokurimit del se janë kontraktuar 5 milion € borxhe. Nëse bazë të kësaj po del se ju i keni shlyer 2 milion borxhe, por jeni hyrë 2.5 milion borxh! Ju i keni kryer obligimet e qeverisjes së kaur, por ju përsëri keni krijuar borxhe, sepse keni kontraktuar punë pa buxhet. Nëse është kështu, atëherë duhet të jep përgjigje UD i Drejtorisë së Financave. Po ashtu për mua është e paqartë dhe kryetari të na përgjigjet në raportin me shkrim të kryetarit të Komunës në pasuesin e dytë thuhet se: “këtë vit buxhetor Gjilani ka thyer kufijtë buxhetor për 2.4 milion € buxhet”. A janë ndërruar vendet me 2.4, me 4.2 apo çka ka ndodhur, sepse në buxhetin e Komunës e kemi një tabelë këtu ku nuk shohim se ka thyerje të kufijve buxhetor, as për të parën as për të dytën!? Ne e dimë se KK i Gjilanit e ka aprovuar buxhetin për vitin 2015 dhe askund nuk qëndron kjo rritje buxhetore as për 2.4 as për 4.2? Ajo rritje që është bërë është bërë për shkak të rritjes së kodit për paga dhe nuk kemi rritje buxhetore në asnjë mënyrë. Nuk është mirë të dilni në opinion dhe të thoni se ka rritje buxhetore për 4.2 milion €, sepse me shkrim i keni 2.4 milion, por në realitet nuk janë as ato!? Thuhet se janë 1.2 milion € për bujqësi? Ne në bazë të raportit financiar i cili është miratuar shihet se janë afër 400 mijë € të planifikuara për bujqësi. Ne dëshirojmë ta dimë se nga po i merrni këto shifra, nga po i merrni këta milion, po i shlyeni borxhet 2 milion €? Nuk është mirë të propagandoni se i kemi 4.2 milion € të hyra, sepse nuk janë realitet.

Te investimet kapitale gjatë vitit 2014 e kemi thënë publikisht se janë 12 milion € investime nga viti i kaluar, sepse nuk janë realizuar shumë projekte të cilat kanë filluar. Është mirë ta dimë, pse janë ndërprerë punimet në Lumin Mirusha, mandej shumë projekte të PPP-së, projekti i Zonës ekonomike rajonale, për të cilin projekt asnjë hap nuk është bërë. Nuk është përmend askund në raportin e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, por as një raport të kryetarit, projekti i Bankës Botërore i ITC-së i cili ka qenë i nënshkruar në vlerë prej 215 mijë €, i cili ka filluar më 2013, por këtë vit nuk ka asnjë veprim dhe asnjë lëvizje!? Po ashtu ka projekte tjera të rëndësishme të cilat kanë filluar dhe janë ndërprerë dhe u përmend projekti i Varrezave të Dëshmorëve, nëse unë di të lexoj shqip dhe besoj se di dhe nëse i kemi

raportet e Zyrës së Kryetarit ku shihet se ka punuar një komision me 10 mars 2014, është konstatuar se në këtë projekt në fazën e parë asnjë parregullsi nuk është gjetur. Nuk është mirë të manipulohet opinion dhe të thuhet se ka hetime në atë projekt. Është mirë kryetari që të na e sjell listën e projekteve të cilat janë nën hetime dhe kërkoj publikisht që të na sjellësh listën e projekteve të cilat janë nën hetime. Sa i përket grandeve të Komisionit Evropian thuhet se donacione, por ne e shohim që ka ikje të dhuruesve, kemi zvogëlim të grandeve, kemi mos realizim të projekteve që janë fituar nga dhuruesit. E dini shumë mirë që në Gjiilan ka pasur investitorë të huaj, kurse sot nuk kemi në Gjiilan dhe asnjë investim nuk e kemi pasur. Ju me investitor, keni komunikim të rëndë ofendues dhe kërcënues, kemi raste të investitorëve të huaj për kërcënimet që iu kanë bërë. Kjo atmosferë dhe kjo klimë e biznesit në Komunë është e tmerrshme. Në fund kisha dëshirë të them se nuk i takon kryetarit me fjalorin e tij të na ofendoj, sepse ne po kërkojmë qasje në dokumente dhe nuk po e ofendojmë askënd, kurse juve nuk po iu konvenon hapja e problemeve në KK. Kryetari e tha se unë asnjëherë nuk kam kërkuar hetime, por personalisht keni deklaruar dhe keni kërkuar hetimin e projektit të anuluar i cili ka pasur të bëjë me dezinfektimin dhe derertarizimin që ka pasur të bëhet në Komunë të Gjiilanit, prandaj duhet të jeni më i përgjegjshëm në deklaratat e juaja.

Leonorë Bunjaku- fillimisht i përgëzoj kolegët për sukseset dhe të arriturat e tyre dhe dëshiroj që këto të arritura të shërbejnë në institucionet ku punojnë.

Shumë gjëra u thanë, por nuk po mund ta them një fakt i cili ndoshta për dike duket cinike dhe simbolike një vlerë prej 900 €, sepse në raport më bëri përshtypje një shifër prej 900 € për furnizim me këpucë për zyrtarë komunal më 2 qershor 2014. Ne për derisa jemi thirr në dietë buxhetore dhe për derisa nëpër shkollë kërkohej mjete edhe për gjëra elementare të participojnë ose japin ndihma, si është e mundur një Komunë të sigurojë për zyrtarët komunal me këtë vlerë 900€ këpucë për zyrtarë, kurse në anën tjetër të kërkohej nga prindërit të japin ndihma për gëlqerosjen e shkollave dhe disa punëve të tjera. Unë kish kërkuar nga ju që të vetëdijesohemi njëherë e përgjithmonë, sepse qytetari ose prindi kontribuon në formë të ndryshme dhe nuk ka nevojë të kontribuojë në këtë formë për sigurim të dollapëve dhe gëlqerosje të shkollave. Të kemi më shumë konsideratë, sepse po e dimë se me çfarë po ballafaqohen qytetarët dhe për shkak të gjendjes jo të mirë po largohen nga vendi me të madhe.

Kërkoj që si qeverisje të keni prioritet arsimin, zhvillimin ekonomik, bujqësinë, por duke mos e harruar edhe një fakt se ju siç qeverisje nuk e keni respektuar fare barazinë gjinore. Barazia gjinore nuk respektohet askund.

Izmi Zeka- është logjike që në përmbyllje të viteve të flitet me lavde dhe është normale që një kryetar Komune t' i thotë anët e mira, por unë preferoj që mos të thirremi në gjëra inekzistente, ka fituar kjo qeveri, prandaj le ta bëjnë punën e vetë dhe është normale ne ta vlerësojmë si opozitë. Mirëpo nuk duhet t' i mbetet hatri askujt pse bëhet ky debat? Ne i dimë të arriturat edhe pse raporti na është dorëzuar me vonesë dhe është parë se është bërë. Mënyra se si ka diversitet, mospërputhshmëri shihet edhe në raport. Mirëpo iu lus mos e përmendni shumë çështjen e hetimeve, sepse kjo nuk është punë e kryetarit të Komunës, nuk është punë e KK-së. Unë e di saktë se sa lëndë janë nën hetime, por kjo nuk është punë e KK-së dhe e kryetarit të Komunës. Kryetari i Komunës ka punë të tjera. Nëse duhet policia ta bëjnë punën e vetë le ta bëjnë, mirëpo edhe këto gjëra që po i themi ne këtu mund të jenë nën hetime, por nuk do të thotë se dikush është duke u gjykuar. Ju lus që të mësohemi me një kulturë komunikimi më ndryshe.

Riadi e përmendi disa herë është një buxhet i planifikuar për vitin 2015 dhe është një standard në këtë rast dhe është shumë vështirë të dalim jashtë të planifikuarës. Unë e kam thënë edhe në partinë time se është vështirë për një kryetar komune, sepse kalojnë 2-3 muaj derisa të adaptohet në vend të punës, kurse pas një viti kërkohej punë intensive. Unë po them me bindje të plotë se çdo punë të mirë që e bën kjo Komunë e bën për qytetarët, kurse unë nuk po ndërhyj në polarizime të ndryshme, sepse subjektet politike nga pak na ngacmojnë i cili fat nuk është i mirë, por kjo po ndodh, prandaj është mirë që të

bëjmë ndonjë ndryshim. Mua më pëlqej Fehmi Sylejmani i cili i bërë ato krahasime përkitazi me PPP-në, por së paku duhet të jetë qëllimi i mirë në bërjen e punës. Unë po them se në raport ka disa tejkallime, sepse raporti ka disa planifikime për 3 apo 6 muaj të së kaluarës ose të ardhmes, prandaj po iu preferoj juve që jeni në pushtet të keni kujdes, sepse ju e keni përgjegjësinë. E kemi edhe ne dhe në atë që po përmendet toleranca, transparenca, atëherë kur kërkon opozita diçka, duhet t' i përgjigjeni. Ne çka është kërkuar i kemi dhënë dhe nuk na ka penguar asgjë. Gjithashtu kur flisni për rezultate, duhet të mos i përmendni më borxhet, sepse keni edhe punë të tjera. Unë e kam një bindje se kur Lutfi Haziri ta përfundojë mandatin sigurisht Komuna do të mbes borxh dhe jo ndoshta me fajin e tij, sepse nuk përfundojnë projektet në tërësi. Uroj që vitit 2015 të jetë më i suksesshëm për Kosovën dhe të ketë sa më shumë njohje ndërkombëtare.

Shpresë Kurteshi – nga kolegët e opozitës u tha që LDK dhe Lutfi Haziri janë votuar duke u parë si një shpresë e vetme për qytetarët e qytetin e Gjilanit i cili është një fakt dhe krejtësisht e vërtetë dhe ashtu ka qenë dhe vazhdon të mbetet i tillë, duke u arsyetuar me punë dhe besim te qytetarët.

Vërtetë është për t' u vlerësuar angazhimi i kryetarit të Komunës dhe i kabinetit qeveritar, sepse po jep rezultate pozitive për Komunën e Gjilanit. Qytetarëve nuk i interesojnë fjalët, por i interesojnë rezultatet të cilat preken në përditshmërinë e tyre jetësore. Krahas me vështirësitë buxhetore me të cilat Komuna po ballafaqohet janë bërë dhe po vazhdojnë të bëhen punë të mira. Pa dashur të flasë për sfera të tjera, por ndalem te punët të cilat janë bërë për rininë. Nuk është e vërtetë se rinia ka mbetur anash. Janë organizuar tryeza, janë zhvilluar aktivitete, kurse të ndryshme, por kjo nuk dot ë thotë që ne duhet të vetëkënaqemi me këto aktivitete, por duhet të vazhdojmë edhe më tutje me punë.

Gjithashtu duhet ta dimë se është bërë edhe Plani i veprimtimit lokal, por ka mbetur që të bëhen edhe disa debate në mënyrë që të kompletohet ashtu si duhet.

Lutfi Haziri- ju falënderoj të nderuar anëtarë të Kuvendit, ne sot po flasim për një Raport nëntë mujor u përmend nga z. Rashiti dhe disa të tjerë, por unë e pranova fillimisht se kam munguar në këtë gjashtëmujor, por kjo është evidentuar nga monitoruesit si lëshim dhe natyrisht dëshiroj për ta konfirmuar se në mënyrë periodike të raportoj para Kuvendit. Dëshiroj ta respektoj rolin e Kuvendit dhe për ta involvuar Kuvendin në ushtrimin e detyrave më kontrolluese. Natyrisht që njerëzve nuk i pëlqejnë kritikën dhe insuatat e caktuara, por kur janë qëllimshme, ato evidentojnë dhe përmirësohen.

Politikani më i madh i botës z. Çerçill e ka thënë se : “opozita është pjesa e shëndetshme e pushtetit”. Natyrisht edhe vetë kam qenë në opozitë dhe e respektoj me kuptimin e plotë të fjalës atë që e ka thënë ai dhe në kuptimin se në opozitë gjithçka shkon mirë, kurse pjesa tjetër shkon keq.

Për pa dashur për të shkaktuar polemika dhe reagime të tjera po i përmend tri çështje të cilat u thanë këtu. Buxheti është aprovuar mbrëmë nga Kuvendi i Republikës dhe ky buxhet nuk ka pasur ndërhyrje gjatë leximit të parë dhe në atë buxhet në kategorinë e investimeve, në kategorinë e shpronësimeve dhe në atë të subvencioneve planifikojmë 4.2 milion € të hyra buxhetore. Buxheti i miratuar do të jetë online dhe secili mund ta gjejë, kurse më herë është përmirësuar çështja e arsimit, sepse ky sektorë ka qenë një ndër më problematikët, por ne i kemi dhënë përparësi për ta përmirësuar gjendjen.

Sa i përket KK-së i cili ka qenë në kufijtë buxhetor, natyrisht se është arrit për ta përmirësuar dhe Qeveria dhe Kuvendi e ka miratuar një buxhet krejt tjetër për Gjilanin dhe tash ka rritje.

Sa i përket listës së borxheve dhe listës së subvencioneve do ta pasqyrojmë në raportin njëvjeçar dhe do t' ia dërgojmë me kohë dhe unë pajtohem shumë me zotri Isufi që të dihet se cilat janë obligimet e Komunës, sa janë subvencionet të cilat janë dhënë dhe kur janë zotuar? Gjithashtu këtu po përmendet edhe rasti i Hendikosit, por po iu njoftoj se ka vullnet për ta rritur subvencionin në vlerë prej 5 mijë e 500 € që i ka pasur Hendikosi deri më tash, por jo marrëveshje me Komunën. Ne i kemi gjet mbi 3 milion € subvencione në gjashtë vitet e kaluara të pambyllura. Ligji është i qartë dhe asnjë subvencion nuk mund të harxhohet nëse ai nuk deklarohet më vonë dhe nuk mbyllet në arkë. Ne dëshirojmë për t' i ndarë përgjegjësitë me përfutuesit. Sado që të jetë vlera, ne dëshirojmë t' i sanksionojmë dhe të jemi të qartë

dhe të përgjegjshëm para ligjit që mjetet mos të merren vetëm si subvencione, por ato të merren dhe të harxhohen sipas destinimit. Sado që të jetë shuma, nuk mund të vendosen parametra të vullnetit të mirë të dikujt, sepse kur epet një shumë e mjeteve, ajo duhet të arsyetohet në fund të vitit. Të merret edhe naftë për nxehje edhe derivate për udhëtim edhe shpenzime për mëditje edhe subvencione për mision edhe për nesër, kjo logjikë e menaxhimit të parasë nuk funksionon dhe nuk toleroj në asnjë mënyrë.

Për atë që ka mjete ato do të harxhohen, do të merren obligimet dhe do të mbyllen dhe mos të mendoj dikush se do të merr subvencione në vitin 2010 dhe ta thërrasin zyrtarin ose Drejtorin e Financave për t' i mbyll. Duhet të dërgojë letër zyrtare, do të arsyetohet subvencioni pse është harxhuar, sepse neve vetëm këtë muaj na kanë ardhur edhe 20 fatura të subvencioneve e të cilat janë problematike. Unë po i përmendi sot për mos t' i përmend më në janar. Na kanë ardhur 10 shpronësime të paragjykuara. Shpronësimi i paragjykuar është kur dikush thotë se domosdoshmërisht në 500 metra të trasës së rrugës afër Lumit Mirusha iks personit duhet t' i merren 5 metra tokë dhe dikush ka marrë para për këso raste.

Këto janë çështje të cilat duhet të zbardhen dhe të mos përsëriten në të ardhmen në asnjë mënyrë dhe ky është angazhim i yni i përbashkët. Po përmenden disa nga problemet në mënyrë që ne të sjellkemi përgjegjshëm ndaj këtij problemi për pa bërë me gisht. Nëse thuhet se janë 35 lëndë nën hetime, anëtar i KK-së ka të drejtë ligjore t' i shkruajë letër Prokurorisë Speciale dhe t' i kërkojë listë, sepse unë nuk mund të jap listë në emër të Prokurorisë. Unë nuk jam titullar që punoj as në hetime as për Prokurorinë, por kam deshtë të informoj se duhet t' i zgjedhim problemet bashkërisht. Nuk kam thënë se këto projekte do të mbyllen (një kategori i projekteve duhet të mbyllen).

Ndërtesa e Policisë regjionale ose duhet të përfundojë ose ne duhet të shpallim të mbyllur dhe më tutje mos të kemi obligime. Gjithashtu edhe Biblioteka nga KE ose duhet të mbyllet ose duhet të përfundojë, ky është një projekt që është gjet me probleme. Sa i përket dhuruesve të tjerë në të gjitha programet në të cilat kemi konkurrar dhe që janë shpallur zyrtarisht në Kosovë, Gjilani ka konkurrar dhe Gjilani ka fituar dhe në asnjë program nuk është refuzuar. Me Komisionin Evropian edhe në vijën buxhetore "Kosova e bukur" edhe në vijën buxhetore "Bashkëpunim ndërkuftar" edhe në vijën buxhetore për subvencionim për kompanitë e vogla dhe të mesme, Gjilani ka dal përfitues, por edhe me Qeverinë Zvicerane mbi 2 milion franga. Gjithçka që është ndërtuar në fshatra këto 15 vitet e fundit nuk ka dal funksionale, prandaj duhet para shtesë për t' i funksionalizuar ato projekte dhe aty duhet të angazhohen kompanitë me autoritet si është Hidromorava.

Mirëpo ka raste të mira, por edhe të lëshimeve, nuk mundet të shihen efektet në qeverisjen në vitin e parë asnjë kryetar komune asnjë përfaqësues më lartë t' i realizojë. Unë e respektoj listën e zotëri Sylejmani që e solli, por efektet në vitin e parë nuk kalkulohen.

Ne gjashtë muaj kemi qenë pa qeveri dhe kemi humbur bukur shumë kohë, por jam sjell karshi situatës me përgjegjësi, sepse unë jam përfaqësues politik. Interesi i përfaqësuesit politik është për ta pasur rolin ndikimin në çdo lloj qeverie. Natyrisht duke qenë përfaqësues i subjektit politik, kam bashkëpunuar dhe kam negociuar deri në fund interesin e subjektit tim.

Vizitat që i kam bërë jashtë vendit nuk janë raportuar, sepse në cilësinë e kryetarit të Komunës kam pasur shumë pak vizita dhe është deshtë t' i refuzoj shumë vizita. Orientimi i im në partneritetin me komuna, qytete dhe regjione jashtë Gjilanit është i tillë që ne t' i rikthejmë bashkëpunimin me komunat belge, franceze, gjermane dhe amerikane. Ndërsa disa vizita tjera që i kam pasur jashtë kanë qenë vizita me karakter tjetër politik dhe që unë do të vazhdoj t' i bëjë, sepse unë e kam ndërtuar për 15 vite këtë profil politik dhe pse jam kryetar i Komunës, nuk do ta shuaj miqësinë dhe rolin tim. Mirëpo edhe të tjerët jam i interesuar t' i bëj miq, sepse ata janë me ndikim në vendimmarrje dhe në realizim të projekteve.

Nuk kam shkuar për të marrë para atje, sepse të gjithë ata që shkojnë për të kërkuar para në Bruksel, është gabim, sepse atje duhet shkuar me projekte dhe programe, pastaj bëhet ftesa për arsyetim dhe në këtë mënyrë mund të fitohet ose jo ndonjë projekt.

Njëri ndër programet e Bashkëpunimit ndërkuftar ka kaluar është shkalla e parë bashkëpunim ndërkuftar në mes Gjilanit dhe Çairit dhe është buxhetim i Komisionit Evropian, por edhe programet tjera do t' i arsyetojmë. Vizita e ime në Tiranë ose Washington ka të bëjë me angazhimet e mia, por asnjëherë nuk ka

munuar angazhimi im në Gjilan, sepse kryetari i Komunës është për të punuar dhe të jetë i përgjegjshëm karshi detyrës së vetë që e ka marrë. Sa i përket uljes së shpenzimeve, unë po iu paralajmëroj edhe njëherë se viti i ardhshëm do të jetë me parametra të njëjta, ne do të vazhdojmë me dietë buxhetore, me shpenzime minimale dhe kështu do të veprohet edhe me kategori të tjera të shpenzimeve dhe jo vetëm reprezentacion dhe ushqim dhe kategoritë e tjera që kanë marrë shumë para. Unë po iu paralajmëroj se edhe 97 mijë € për ushqim dhe pije nuk janë paguar. Këto pagesa janë procese gjyqësore, sepse nuk mund të paguhet ajo kategori e borxheve në raport me Hotelin “Kristal”, Restorantin “Luli” dhe “Bujana”. Disa fatura të cilat më kanë kaluar për pa i parë janë paguar e që më vonë e kam parë, por kjo nuk paraqet problem, por jam i interesuar që të kemi disiplinë dhe rend sa i përket shpenzimeve.

Çdo kryetari i Komunës që vjen nuk dallon më shumë se i pari i qytetarëve dhe nuk ka të drejtë të harxhoj reprezentacion më tepër se kryetari i Nju-Jorkut. Shpenzimet për reprezentacion kanë qenë më të mëdha se kryetari i Nju Jorkut, kjo duhet të ndërpritet njëherë e përgjithmonë. Këtë shpenzim nuk e ka bërë një njeri, por e ka bërë një mekanizëm i tërë i cili ka bërë shpenzime të mëdha dhe duhet përfundimisht të marrë fund kjo praktikë. Edhe viti i ardhshëm do të jetë me përkufizime dhe për këtë po e them se përgjegjësi më tepër ka stafi im, drejtorët, këshilltarët e mi dhe administrata. Mirëpo KK këtë vit do të ketë mjete më shumë, por edhe do të bëj shpenzime më shumë, sepse KK ka qenë institucioni i cili më së paku ka bërë shpenzime.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon nga anëtarët e Kuvendit që ta aprovojnë pikën 2 të rendit të punës?

Aprovohet pika 2 e rendit të punës: Raporti i kryetarit të Komunës për vitin 2014 me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit, 4 ishin kundër, kurse të tjerët nuk u deklaruan për asnjë variant të votimit.

3. Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 016-32277 e dt. 19.03.2014

Hevzi Matoshi- Rregullorja mbi ndryshimet dhe plotësimet e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, **01. nr. 016-32277 e dt. 19.03.2014** është i bazuar në dispozitat e neneve 8, 12-16 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-049, GZ. e Republikës së Kosovës, nr. 27 e datës 03.06.2008 si dhe dispozitat e Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të datës 06.11.2014.

Me këtë Projekt parashihet ndryshimi dhe plotësimi i rregullores aktuale në dispozitat që prekin shërbimet sa i përket lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve zyrtare, shërbimet publike komunale, urbanizmin dhe një pjesë të bizneseve.

Taksat për leje ndërtimore më nuk parashihen të përcaktohen me rregullore, sepse konform nenit 22 të Ligjit nr. 04/L-110 për ndërtim, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18 e datës 03.07.2012, kjo taksë përcaktohet nga Drejtoria për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit.

Në këtë rregullore do të përcaktohen edhe taksat dhe tarifat për aktivitetet për të cilat kërkohet **Leje Mjedisore. Aktivitetet për të cilat komuna lëshon leje mjedisore janë të përcaktuara me udhëzim përkatës nr. 02/2012 për dhënien e lejes mjedisore komunale.**

Taksa tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore për disa sfera të caktuara si për arsim dhe shëndetësi, kadastrë nuk parashihen të përcaktohen me këtë rregullore, sepse ato janë të përcaktuara sipas kompetencës nga Ministritë përkatëse të Qeverisë të Republikës të Kosovës dhe aplikohen nga organet e Komunës në pajtim të udhëzimeve përkatëse administrative.

Lartësia e taksave është përcaktuar në bazë kostos së punës për shërbimet dhe aktivitetet që i ofron Komuna, konform dispozitave të nenit 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Zijadin Maliqi- e dëgjuam edhe udhëheqësin e Zyrës Ligjore i cili theksoi se kjo rregullore i ka kaluar të gjitha procedurat e parapara me ligj, janë mbajtur dy debate publike dhe është në përputhshmëri me të gjitha ligjet që u thanë nga zyrtari ligjor. Gjithashtu është marrë edhe pëlqimi nga Ministria për Buxhet dhe Financa, prandaj ne grupi i anëtarëve të Kuvendit të LDK-së i përkrahim këto ndryshime në këtë rregullore. Në ato tarifa ku ka ndryshime ka zbritje, por në disa tarifa ka vetëm precizim më detal si p.sh. supermarketet të cilat janë të precizuara më detalisht edhe atë në bazë të m² dhe nuk janë të gjitha të një niveli siç ka qenë më parë. Do të thotë janë ndryshime të arsyeshme të cilat ne si grup i anëtarëve të LDK-së i përkrahim.

Riad Rashiti- ne si grup i PDK-së e kemi analizuar këtë rregullore e cila është sjell sot për t' i aprovuar ndryshimet të cilat i keni propozuar. Në bazë të analizës sonë e kemi vërejt se kjo rregullore ka ndryshime bukur shumë, por që në përmbajtje nuk vërehen se ka ndryshime të mëdha. U tha se te pika 3 ka detajime, sepse janë detajizuar taksat. Mirëpo ne po e vërejmë të kundërtën, sepse nuk janë precizuar taksat, por mendojmë se janë rikthyer taksat. Ne e dimë që në vitin 2012 janë hequr të gjitha taksat për të gjitha kategoritë e bizneseve me përjashtim të kompanive të mëdha të cilat kanë shtrirje nacionale në Komunën e Gjilanit, kurse minimarketet e vogla janë liruar. Marketet lokale si “Drini” “Agmia” nuk kanë pasur taksa, sepse kanë qenë të nivelit lokal. Ndërsa sipas këtij propozimi po vërehet se këto taksa po rikthehen . Po ashtu është gjendja edhe me restorantet, sepse nuk kanë qenë të ngarkuara me taksa komunale, por sot ato prapë po ngarkohen me taksa komunale, por edhe hotelet, motelet, pompat e benzinës, klinikat mjekësore, ambulancat, noteret, avokatët, ne jemi kujdesur që mos të kenë taksa, por ky propozim po i rikthen të gjitha taksat për këto kategori.

Mirëpo fatkeqësisht neve materiali që po na vjen neve po na vije vetëm propozimi për ndryshime, por nuk po na vije rregullorja bazë dhe është mirë që përveç propozimeve për ndryshim është mirë që të na i sillini edhe rregulloren bazë e cila ka qenë e aplikueshme deri më sot.

Në bazë të kësaj rregulloreje i kemi 21 tarifa të reja për bizneset në Gjilan . Kjo është një ngarkesë për këto biznese, sepse këto tarifa të larta konsiderojmë se do të ndikojnë negativisht në veprimtarinë e tyre afariste. Qëllimi i ynë është që të mbështeten bizneset lokale, por i tillë ka qenë premtimi edhe i LDK-së, por këto mbesin vetëm fjalë dhe jo të realizuara në vepër. Me rregulloren e para kësaj që është në fuqi kanë qenë të ngarkuara hipermarketet që kanë shtrirje nacionale në vlerë prej 1 mijë €, siç është “ Wiva”, “ETC”, kurse këto komunale nuk kanë pasur taksa, prandaj po e përsëris që kthimi i këtyre taksave është i rëndë, sepse ndikon në afarizëm të tyre dhe në zvogëlim të vendeve të punës. Propozimi për restorantet që të taksohen në shumë prej 300-500 €, është shumë e madhe, hotelet në vlerë prej 500€, pompat e benzinës me nga 300-500€, klinikat mjekësore, ambulancat, rëntgenët, laboratorëve, stomatologët prej 200-300 €, auto shkollet 200 € etj. Kështu ka edhe shumë kategori të tjera të cilat janë tarifuar prej 200-500 €. Mirëpo përveç këtyre taksave të bizneseve në këtë rregullore janë planifikuar dhe janë fut edhe taksa të reja të cilat nuk kanë ekzistuar deri më tash dhe si shembull janë lejet mjedisore, për të gjitha bizneset në Komunën e Gjilanit. Si shembull janë të gjitha fabrikat të cilat merren me prodhim kanë tarifë deri më tash nga 500 € dhe kjo është e paarsyeshme e cila nuk ndikon në stimulim, por ndikon negativisht në ambiciet për prodhim. Një tarifë 500€ për leje mjedisore është shumë e lartë dhe e papranueshme.

Disa biznese të vogla të cilat merren me rritjen e shpezëve dhe bagëti po tarifohen në shumë prej 100-350 €, por edhe autolarjet po ngarkohen me nga 100 €, po ashtu ndodh edhe me qebaptoret.

Ne e dimë se në çfarë gjendje janë bizneset e Gjilanit, sa kanë profit, sa kanë punë, sidomos vitin e kaluar dhe këtë vit , kurse ato të taksohen në vlerë prej 100 €, për ne kjo është shumë e madhe. Po ashtu furrat dhe produktet për prodhim të bukës dhe miellit po taksohen me nga 350 €, kur dihet se shumica e prodhimeve të miellit kanë falimentuar. Ne në vend se t' i stimulojmë këto prodhime ju po i rritni taksat

deri në 550 €. Po ashtu është tarifuar edhe rritja artificiale e peshkut me sipërfaqe deri në 500 €, por unë nuk e di se a ka në Gjilan rritje artificiale të peshkut, por edhe sikur të kishte do të ishte mirë të stimulohej dhe jo të ngarkohej me 500 €.

Po ashtu fabrikat për prodhim të lëngjeve, frutave dhe pijeve freskuese po taksohen me 500 €, prandaj edhe kjo është ngarkesë e madhe. Nuk dua t' i numëroj të gjitha, sepse janë 35 kategori të tjera të bizneseve prodhuese të cilave po i kthehen taksat e të cilat janë mjaft të rënda. Ne dimë se kemi me mijëra biznese dhe me mija punëtorë dhe do të duhej si Drejtori për Zhvillim Ekonomik, duhet Komuna të mendojë dhe hartojë programe për stimulimin e tyre për t' i rrit kapacitetet e tyre dhe për ta rrit prodhimin. Ndërsa për bizneset shërbyese për të cilat i kemi analizuar propozimet në këtë rregullore kanë taksë vetëm 30 €, prandaj vetëm këtu ka zvogëlim të taksave.

Te neni 3 tarifa 19, propozohet të jetë 5 €, kurse deri më tash ka qenë 100 €, mirë është që e keni bërë këtë lirim të taksës, por duhet dhënë sqarime pse e keni liruar këtë taksë. Mua më duket se qëllimi i këtij lirimi e ka njëfarë prapavije, sepse bëhet reklamimi më pak se 30 ditë ka qenë 100 €, kurse ju e keni zbrit në 5 €. Nëse pllakati është i vendosur në pronën private të vetin e ka reklamimin që paguhet vetëm 2 €, e që do të thotë se edhe këtu ka qenë 100€, është zbrit në 5 €, kurse tash në 2 €.

Për mos ta zgjat më shumë definitivisht kjo rregullore për mendimin tim dhe grupit të PDK-së është e rëndë, sepse shumica e bizneseve me shumë vështirësi kanë mbijetuar, kurse ne për çdo vit i kemi liruar nga obligimet, kurse ju tash menjëherë i ktheni ato taksa të cilat janë të papërballueshme.

Krenare Latifi- sa i perket rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjopa komunale ne si grup i kemi analizuar dhe kemi parë disa mangësi teknike prandaj mendojmë se kjo rregullore është dashtë të jetë me e plotsuar që ndryshimet e bera, të paraqiteshin edhe në rregulloren e re.

Psh. Duke u nisur nga pika 1 neni 3 I rregullores Baze, Tarifa nr.2 e cila thotë – të fshihet, unë mendoj se ..pajtohem për këtë pikë në rast se bëhet fjale për Ceremoninë e kurorizimit për shkak se është një letësim për qytetarin, por kur është fjala për ..Neni 3 Tarifa nr. 4 ku thuhet se kurorizimi jashtë orarit të punës, në si grup mendojmë se kjo tarifë nuk ka nevojë të fshihet kur e dime se ..për kërkesa për kurorizim jashtë orarit të punës, sic kemi parë edhe më herët – ky shërbim nuk ka nevojë të fshihet, ndoshta kishte qenë më mirë ..vetëm të bëhet ulje nga 30eur në 20 euro. E them këtë me përgjegjësi të plotë se, ai i cili don të kurorizohet në ditën e martës pas orarit të rregullt, duhet ta paguaj ceremoninë e kurorizimit prej 20eur. Neni 3 rregullores baze tarifa nr.19 – që ka të bëjë me Lëshimin e vertetimit mbi shpenzimet e varrimit – Ne mendojmë se nuk ka nevojë të rritet tarifa, ku ne edhe ashtu jemi pajtuar që të lirohen nga shpenzimet e varrimit.

Apo neni 4 I rreg. Pika 12 tarifa 53 të fshihet, ndërsa në rregulloren e vjetër tarifa 53 nuk duhet të fshihet. Unë jap propozimin që të mbetet ashtu sic është ..ose të paktën vetëm të zbritet tarifa në 100eur për këtë kategori, ku e dime se këtu në këtë veprimtari krijohen të Hyra ..me më pak shpenzim.

Të neni 3 tarifa nr.26 që është parapare, për Aplikim për shtetesi.. në pajtohem. Në si opozite pajtohem për fshirje, duke e ditur se shumë bashkatdhetarë e ..shqiptarët nga Presheva Medvegja e Bujanovci..të kenë përfitim nga kjo pikë.

Të neni 3 tarifa nr.21 e cila është propozuar për vendosje të pagesës 2 euro e cila ka të bëjë me Lajmerim dhe Ç`lajmerim të vendbanimit unë mendoj se kjo tarifë vecse është vendosur 2 Euro,

Sa i perket neni 3 nga tarifa 2.12 e deri në pikën 2.16 e cila ka të bëjë me marketet super marketet e hipermarketet ..unë mendoj se të kjo e fundit, Hipermarketet ..duhet të kemi një rritje prej 1200 - 1500eur duke marrë për bazë ..madhësinë, qarkullimin si dhe nr. e të punësuarve – poashtu, Gamen e gjere të artikujve që posedojnë këto veprimtari.

Për shkak të fshatrave .. neni 3 tarifa 2.26 .. kur është fjala për pompa në pjesët rurale në Fshatra ..unë mendoj që të lirohet, tariff nga 300 në 200. Këtë e them ..duke marrë parasysh se ..në fshatra vecse..po mbyllen Pompat e benzines. Sic janë pompa Zheger, pompa në Uglare etj.

Nevzad Rushiti- unë e kam një kërkesë të qytetarëve dhe jo personale timen, e cila kërkesë ka të bëjë me rastin e ceremonisë së varrimit për të cilin rast në Kuvendin e kaluar kemi marrë vendim që shpenzimet e varrimit t' i heq Komuna dhe Gjilani është Komuna e parë e cila i ka marrë për obligim të t' i kompensojë shpenzimet e varrimit. Mirëpo një mangësi të cilët qytetarët po e thonë është mbulimi i varrit ose ceremonia e fundit. Unë propozoj që Kuvendit ta propozoj edhe një shtesë në rregullore në një vlerë për 10 € ose më tepër për mbulim të varrit.

Arben Mehmeti- unë e kam një propozim të vogël, sepse është e qartë që është problematike të bëhen ndryshime të mëdha, por te pika 3 (Kompanitë publike nacionale), në shumicën e komunave është 30% pagesa e pagës bazë, prandaj propozoj që të harmonizohet dhe të jetë 30% e pagës bazë.

Te neni 4, pika 4 unë nuk e kam të qartë sepse aty thuhet "pas tarifës 11, shtohet tarifë e re me këtë përmbajtje, shfrytëzimi i hapësirës publike për pirje të duhanit (objekt i përkohshëm montues).

Për mua është e paqartë pse të vendoset kjo pjesë dhe, praktikisht i bie se përkohësisht do të respektohet pirja e duhanit, kurse me një kohë të hiqet, sepse aty po bëhet një objekt montues. Për mua kjo është jo serioze, sepse kjo është një lloj i legalizimeve të uzurpimeve, sepse kafiterive do t' i lejohet përkohësisht për t' i shfrytëzuar një objekt ku pihet duhani. Kjo për mua është jo serioze dhe unë jam që të hiq ky paragraf.

Fehmi Sylejmani- për pa deshtë të replikoj me z. Rushiti i cili e ngritit çështjen e ceremonisë së varrimit (procedurën përfundimtare, mbulimin e varrit), unë mendoj se ndoshta e ka plotësisht të drejtë, por në aspektin fetar e di se është mëshirë që të afërmit ta bëjnë mbulimin e kufomës. Unë mendoj se me këtë rast nuk bën të bëjmë asnjë ndryshim, prandaj më mirë është që të mbesin ashtu siç ka qenë deri më tash.

Nevzad Rushiti- unë nuk e thash se ne pjesëmarrësit nuk duhet të marrin pjesë në varrim ose të hedhim dhe me dorë, por unë besoj që ky Kuvend dhe qytetarët e Gjilanit janë duke e vërejtur se këtë gjendje se është problem kur është temperatura e lartë 30-40 gradë, ose nëse ka të reshura, shi, borë është problem. Unë mendoj se nëse e bëjmë edhe një nen në projektin, atëherë projekti do të jetë i kompletuar.

Isa Agushi- unë plotësisht pajtohem me parafolësin tim Riadin, sepse duke e pasur parasysh falimentimet e ndërmarreve të ndryshme dhe kompanive e të cilat janë në kolaps taksa për motele dhe hotele është shumë e lartë. Unë e kam një biznes të vogël në qytet dhe për këtë biznes më duhet të paguaj 400 €. Kjo është një shumë e madhe jo vetëm për mua, por edhe për kompanitë e tjera, sepse këto kompani nuk kanë afarizëm të duhur dhe për çdo ditë gjendja po vështirësohet. Unë fare nuk pajtohem me këto shifra, sepse janë shuma të mëdha, prandaj mendoj se duhet bërë edhe një rishikim ose të bëhet një zbritje për 50%.

Nevzad Isufi- unë mendoj se do të ishte mirë që të bëhet një kategorizim i këtyre taksave. Të bëhet dallimi në mes të produktit, tregtarit dhe veprimtarisë shërbyese. Ne prodhimet në çdo mënyrë i kemi të pakta, prandaj si masë stimuluese për njerëzit që kanë ambicie për të investuar dhe për të punësuar punëtorë do të ishte stimulimi, zvogëlimi i taksës në minimum. Mandej një pjesë e lëndës së parë nuk janë liruar nga doganat, pastaj kanë vështirësi në mirëmbajtje etj. Për këtë arsyeje veprimtarit prodhuese nuk duhet krahasuar me veprimtarit shërbyese dhe tregtare dhe për këtë arsyeje jam për favorizim të biznesve prodhuese, sidomos vendore. Këtë kategori duhet stimuluar në njëfarë forme dhe gjobitur duke i vënë taksa të larta.

Selami Xhemajli- unë po e theksoj edhe atë që e kam thënë edhe në KPF dhe është mirë që sekretaria krahas rregullore për plotësime dhe ndryshim të na i dërgoi edhe Rregulloren aktuale ose atë bazë.

Për t' i dhënë seriozitet rolit të anëtarit të Kuvendit, shumë më lehtë është t' i bëjmë krahasimet dhe do ta dimë se çka po ndryshohet? Sa i përket tarifave, unë në parim e përkrahi këtë rregullore, mirëpo për

kategorizimet që u përmenden nga kolegët edhe unë mendoj se ndoshta duhet ta bëjmë një analizë më të mirë si p.sh te supermarket të mos bëhen tarifat me metra katror, por ndoshta më mirë është të tarifohet në bazë të qarkullimit vjetor që e kanë. Ky model vlen edhe për motelet dhe kjo procedurë mund të kryhet përmes një raporti të cilin mund ta marrim në Administratën Tatimore.

Zijadin Maliqi- kjo rregullore ka ardhur tash në fund të vitit, kurse prej fillimit të vitit të ardhshëm menjëherë duhet shpërndarë vendimet në terren sipas kësaj rregulloreje. U tha nga Selamiu përcaktimi i tarifave, sipas qarkullimit që i ka një subjekt afarist, por ne nuk kemi të drejtë ta bëjmë këtë, sepse është në kundërshtim me MEF-in. Të vetmen mundësi sipas aftësisë tregtare apo prodhuese e ka Administrata Tatimore për ta tatimuar ndërmarrjen. Këto janë taksa vjetore dhe nuk kemi mundësi t' i tatimojmë në atë aspekt. Për mua është e paqartë dhe kërkoj nga Zyra Ligjore që të jep sqarime si janë tatimuar lejet mjedisore, sepse unë e di se këto janë të parapara me ligj dhe çdo Komunë është e obliguar, por Zyra Ligjore kërkoj të jep sqarim më detal.

Hevzi Matoshi- unë po i sqaroj se i përket tarifave të ulëta apo të larta janë drejtorët këtë dhe ata duhet të japin sqarime, kurse unë do të ja sqarime vetëm për tarifat ligjore. Në rend të parë dua të iu siguroj se secilën rregullore bazë e keni marrë dhe atë e keni në faqen e Komunës.

E dyta Ligji për financat e pushteti lokal nuk parasheh për të bërë ndarje duke pasur parasysh numrin e punëtorëve, duke pasur parasysh të ardhurat që i realizon kompania, po ashtu edhe të hyrat që i ka gjatë një viti. Thjeshtë ne po bëjmë fjalë për një taksë vjetore. Taksa për afarizëm për leje të ndërtimit, përpos lejes së ndërtimit duhet pasur parasysh se në bazë të udhëzimit të Ministrisë përkatëse për Mjedis janë përcaktuar edhe veprimtaritë apo aktivitet me të cilat Komuna duhet t' i tarifojë me rastin lëshimit të lejes mjedisore e cila lëshohet para lejes së ndërtimit. Këto janë aspekte ligjore dhe nga janari i vitit 2015 duhet të zbatohen. Sa i përket bizneseve prodhuese, ato absolutisht nuk janë prek, por janë stimuluar nga viti i kaluar dhe është bërë një modifikim një radhitje sa i përket veprimtarive të cilat janë shërbyese.

Riad Rashiti-unë desha ta bëjë një reagim të shkurtës, sepse Rregullorja e vitit 2014 nuk është në faqen e Komunës, kurse e dyta absolutisht nuk qëndron ajo se veprimtarit prodhuese nuk janë prekur fare, sepse këtu po shihet se kjo nuk qëndron. Rregullorja në fuqi që është asnjë ndërmarrje prodhuese nuk ka pasur taksë, kurse tash ka ndërmarrje prodhuese të cilat kanë taksë. Pesë kategori të ndërmarrjeve prodhuese janë të taksuara. Prodhimi i shpezëve, nuk ka qenë taksë, furrat e bukës, pijet freskuese dhe frutave.

Sot në Gjilan qindra ndërmarrjeve prodhuese po i kthehen taksat. Unë iu lus shumë që ta merrni parasysh këtë rregullore dhe ta akomodoni me mundësitë reale të bizneseve të Gjilanit, sepse nuk është në përputhje me ligjet dhe nuk është punë e madhe nëse kjo rregullore përpunohet edhe njëherë dhe pas një muaji miratohet, sipas standardeve.

Hevzi Matoshi- unë u mundova të jem sa më i shkurtës për mos ia marrë kohën të tjerëve, por unë në tavolinë e kam Udhëzimin administrativ nr. 10/2012 e cila flet për dhënie të lejes mjedisore. Të gjitha këto që u përmendën deri më tash janë në këtë udhëzim dhe në rregullore janë përcaktuar vetëm tarifat. Të gjitha këto veprimtari që po përmenden nga Riadi, të gjitha janë në këtë udhëzim dhe ne nuk i kemi zbuluar, por është udhëzim i cili ka ardhur nga ministria përkatëse.

Ibish Ibishi- më herët kolegu, Selami e paraqiti formën në bazë të së cilës do të kishte mundur të tarifohet bizneset. Mirëpo ne si KK, nuk kishim pasur mundësi t' i bëjmë tarifat në bazë të qarkullimit vjetor, sepse në bazë të pozitës se ku zhvillohen bizneset dhe si shembull është nuk është si një biznes i cili zhvillon aktivitet në fshat dhe e ka të njëjtën veprimtari sikur ai në qytet, prandaj këtë duhet ta keni parasysh. Unë mendoj se nuk është i njëjtë zhvillim i biznesit në fshat me atë në qytet, ose në periferi.

Kjo rregullore sipas meje duhet edhe njëherë të rishikohet dhe të bëhet një baraspeshim i cili do t' i kishte kënaq edhe ata të cilët zhvillojnë biznes dhe të ishte përmbush një kërkesë e KK-, por të ketë dallime ose të sillet një propozim - rregullore, sepse kjo nuk është përfundimtare dhe le të ulen këto tarifa, sepse mendoj se janë të ngarkuara bizneset me këto tarifa.

Ismail Jonuzi- duke marrë parasysh ndjeshmërinë që bizneset preken në këtë kohë krize, jemi munduar të jemi të kujdesshëm duke i bërë krahasimet edhe me rregulloret e mëparshme. Gjilani është një ndër komunat e rralla që i liron të gjitha kompanitë prodhuese dhe tregtare, këtë po e them me përgjegjësi, kur është fjala për taksa. Në këtë rregullore janë të përfshira kryesisht veprimtaritë shërbyese. Këtu i keni edhe kompanitë e nivelit nacional, por edhe kompanitë e sigurimeve, bankat dhe institucionet mikro-financiare, agjencitë e transferit të parave, kompanitë e telefonisë. Për herë të parë jemi munduar t' i seleksionojmë se çka është marketi, supermarketi dhe çka është hipermarketi. Gjithashtu edhe te restorantet të cilat edhe në të kaluarën ka qenë edhe restorantet, motelet dhe hotelet, por ne i kemi ndarë dhe në të kaluarën ka qenë hotele dhe restorante me madhësi 300-500m , ne i kemi ndarë si restorante, motelet dhe hotelet si të veçanta. Ne jemi munduar t' i përfshijmë të gjitha këto që janë shërbyese e që nuk e dëmtojnë biznesin e të cilat janë kryesisht kategori shërbyese.

Sokol Haziri- unë po përgjigjem shkurtimisht dhe së pari po i përgjigjem z. Riadit i cili pyeti për një taksë e cila ka qenë 100 €, por e cila është zbrit në 5 €. Mirëpo kjo është taks ditore për ditë qëndrimi dhe kështu është e propozuar dhe nëse ka ndonjë gabim teknik ne mund ta përmirësojmë. Sa i përket postareve, po i sqaroj Kuvendit se sipas Ligjit për banesa, nuk do të trajtohen më si fasada publike dhe nuk do të jenë barrë e Komunës, por do të jenë në shfrytëzim vetanak të banorëve.

Sa i përket çështjes së varrimit, ato gjëra janë të precizuara, por mbulesa e varrit nuk është përfshirë, por për ta bërë ndonjë ndryshim duhet ndonjë procedurë më e gjatë si ritenderimi dhe këtë mund ta vendos Kuvendi.

Nazim Gagica- sa i përket taksave për lëshim të certifikatave dhe dokumenteve zyrtare kemi lëvizje të lehtë në ngritjen dhe uljen e normave tarifore. Kemi rritje të normave tarifore për shërbime të luksit dhe ulje të normave tarifore për shërbime të domosdoshme. Për shërbimet e domosdoshme aty ku kemi të bëjmë me riregjistrimet në librin amë të lindjes, martesës apo vdekjes të cilat janë shërbime të domosdoshme për qytetarët, kurse shërbime të luksit i konsiderojmë kurorëzimin (nëpër restorante) dhe unë konsideroj se në këtë rast duhet ta kemi një ngritje edhe më të lartë. Unë kam kërkuar që këto norma të jenë edhe më të larta (50) €, sepse edhe zyrtarët tanë mbesin nëpër restorante në sezon të verës. Gjithashtu kemi ulje të normave tatimore edhe tek korrigjimet e mëvonshme për shkak të gabimeve të shumta që janë bërë në sektorin e gjendjes civile, sepse janë gabime të cilat janë bërë nga zyrtarët.

Në fund po theksoj se këto lëvizje janë shumë të arsyeshme dhe duhet të votohen, sepse edhe rritja e taksave dhe ulja e tyre ndikon në rritjen e të ardhurave kombëtare nëse menaxhohen drejtë.

Riad Rashiti- unë desha një përgjigje të shkurtës t' ia jap drejtorit për Zhvillim Ekonomik, se pse ai flet kështu!? Në rregulloren e vitit 2013 te neni 4 janë 14 kategori të bizneseve. Në këtë propozim të tuajin në të njëjtin nen janë 35 kategori të bizneseve. Nga ko po shihet se ka rikthim të taksave. Për t i lexuar të gjitha janë shumë, por kjo rregullore ka rikthim të taksave.

Ismail Jonuzi- sa për sqarim, te supermarketet rritet numri, sepse i kemi ndarë në disa kategori si:market, supermarket, hipermarket, por gjithashtu ka ndodhur edhe te motelet dhe restorantet. Gjithashtu është e vërtetë se e kemi shtrirë edhe fazën e disa kategorive shërbyese si janë: diskotekat, diskobaret, klubet e natës, kolegjet universitare private, autoshkollat, pishinat dhe noteret. Këto janë disa kategori shërbyese dhe asnjë prodhuese dhe tregtare.

Riad Rashiti- te supermarketet me rregullore të vitit 2014 është vetëm një nen 2.11, hipermarketet dhe supermarketet me shtrirje nacionale 1 mijë €. Kjo është e vetmja taksë dhe nuk ka pasur as për supermarketet as për minimarkete. Do të thotë që kanë qenë të liruara edhe supermarketet e mëdha. Mirëpo sot po tarifohen të gjitha minimarketet dhe shitoret e vogla që nga 100m² e më tutje po tarifohen. Ju lutem merreni edhe njëherë këtë rregullore analizone si duhet dhe e sillni në Kuvend!?

Arben Maliqi- unë jam i mendimit që kësaj rregulloreje sot të mos ia japim vizën! Këtë po e them se sipas mendimit tim ka shumë gjëra të pa qartësuara dhe ka shumë gjëra për të cilat duhet të mendojmë mirë dhe t' i analizojmë mirë. Këto janë taksa me të cilat qytetarët në çdo mënyrë janë të ngarkuar, prandaj ta analizojmë edhe njëherë dhe pas një muaji e kalojmë. Në këtë rregullore shumë gjëra janë të paqarta. Unë më tepër e mora fjalën rreth tarifës për kafiteri të cilin biznes e njoh dhe nuk mund ta kalojmë shkel e shko dhe pa kriterë. Nuk duhet hapur kafiteri afër shkollave, aty ku pengohet qytetari për të ecur lirshëm, ku ka hapësirë shumë të ngushtë etj. Të bëhet një komision i posaçëm dhe t' i shikojë ato mundësitë se ku ka mundësi t' i epet dikujt hapësira. Nuk guxojmë t' i trajtojmë të gjithë njëjtë, sepse unë po e shoh fjalën hipermarket, supermarket. Faja hipermarket do të thotë market i mrekulluar, por edhe atë që tha Ibishi është e vërtetë, sepse nuk është si biznesi në qytet si në fshat. Ne duhet t' i analizojmë gjërat mirë dhe t' i shikojmë ato lokale të cilat kanë më shumë të hyra, për ato të kemi kriterë tjera, nuk mund t' i barazojmë të gjitha. Unë iu lus edhe njëherë që ta analizoni mirë këtë rregullore.

Valentinë Bunjaku Rexhepi- i kemi pasur dy debate për këtë rregullore ku keni pasur mundësi të i jepni vërejtjet, ka kaluar në KPF, prandaj iu lus që të deklaroheni se kush është për aprovim të kësaj rregulloreje?

Aprovohet pika 3 e rendit të punës: Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 016-32277 e dt. 19.03.2014, me 15 vota të anëtarëve të Kuvendit, 9 ishin kundër, kurse dy abstenuan.

4. Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës në Shërbimin Civil Komunal

Hevzi Matsi-Me këtë projekt-rregullore, nga rregullorja aktuale në fuqi eliminohen dispozitat të cilat rregullojnë fushën e shkalles së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve sepse me miratimin e Ligji Nr. 04/L-161 datë 16 maj 2013 për sigurinë dhe shëndetin në punë nuk ka obliguar punëdhënësit që të miratojnë rregulla që prekin këtë fushë sepse e tëra është rregulluar me ligj, me përjashtim rregullimit të çështjes së pajisjes me mjete personale mbrojtëse që i lihet në kompetenca punëdhënësve.

Bazuar në dispozitat e sipërcituara propozohet miratimi i këtij projekt-rregulloreje që përcakton Pajisjet Personale Mbrojtëse në Punë për të cilat është kompetentë punëdhënësi ti sigurojë për një kategori të caktuar të punëtorëve varësisht nga natyra e vendit të punës mund të jetë i rrezikuar shëndeti i tyre.

Në kuptim të kësaj që përmend në arsyetim të këtij projekti të rregullores kërkojmë të miratoni ndryshimet dhe plotësimet në rregulloren aktuale në fuqi.

Jashar Jashari- kjo është një rregullore e cila ka për bazë sigurinë e punëtorëve në punë, për ta ruajtur shëndetin e tyre dhe për t' i siguruar punëtorëve kushte më të volitshme dhe është një nga objektivat e kryesore për këtë çështje në vende ku ata punojnë duke i ofruar pajisje profesionale për punë. Me këtë rregullore, ndalohen edhe sëmurjet profesionale dhe në mjekësi është një thënie se : “ më lehtë është që ta parandalosh një sëmurje, se sa ta mjekosh atë”. Në emër të grupit kuvendar të LDK-së ne përkrahim këtë rregullore dhe kërkojmë që kjo të aprovohet?

Për të mos mbetur borxh kam për të thënë edhe diçka tjetër, sepse më kanë obliguar qytetarët e Rugës së Prishtinës, rruga “Motrat Qiriazit” që në emër të tyre ta falënderoj publikisht drejtorin e Drejtorisë për Shërbime Publike, z. Sokol Haziri për punën dhe përkushtimin e tij që i ka bërë në të gjitha anët e qytetit dhe të cilit i dëshirojmë suksese dhe punë të mbarë.

Gjithashtu e përshëndes edhe kolegun tim shumë të nderuar Imet Rrahmani i cili është emëruar në postin e ministrit të Shëndetësisë të cilit i uroj suksese dhe punë të mbarë, por gjithashtu edhe z. Arben Maliqit ia uroj titullin e dr. të shkencave sportive.

Myzaferi Ismaili- në pikën e katërt të rendit të punës për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës në Shërbimin Civil Komunal, po theksoje shumë institucione private, por edhe shoqërore nuk janë duke u respektuar ato masa të nevojshme të sigurimit në punë dhe mbrojtjen e tyre në vend të punës. Sa i përket institucioneve private ato duhet të kenë kujdes më tepër gjatë punës së tyre që punëtorët të pajisen me masa mbrojtëse të punës në punishtet e tyre siç janë kapelat mbrojtëse të punëtorëve për t’u verifikuar se cila kompani është duke i kryer punët. Në këtë mënyrë koleg të nderuar, punëtorëve do t’i sigurohen edhe kushte dhe të mbrohet shëndeti i tyre në raste të rrezikut.

Do të shtoj edhe diçka se përveç nxënësve të cilët duhet ta mbajnë uniformën shkollore e që është një numër i vogël i tyre, por këtë duhet ta bëjnë të gjithë nxënësit, por shembull edhe më i mirë do të ishte që edhe mësimdhënësit të bajnë uniformë gjatë procesit mësimor. Me një preventiv të tillë të punëtorëve lëndimet e punëtorëve dot ë ishin më të vogla dhe nuk do të kishte pasur raste me fatalitet, kurse cilësia e procesit edukativo-arsimor do të jetë më në nivel.

Arben Mehmeti-ky është edhe një model i punës së qeverisjes së re, për dallim nga e kaluara e cila ka punuar për pa e siguruar shëndetin e punëtorëve. Këtë gjest të kësaj qeverisje duhet përshëndetur dhe të ecet përpara me procese të tjera.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 4 e rendit të punës?

Aprovohet pika 4 e rendit të punës: Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës në Shërbimin Civil Komunal, me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan

4. Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve

- Hevzi Matoshi - Meqenëse subvencionet përfshijnë transferet për subjektet e ndryshme, të ardhurat e të cilave nuk mbulojnë shpenzimet e tyre dhe për këtë diferencë kërkojnë të sigurojnë mbështetjen financiare nga komuna, andaj lidhur me shumën e caktuar sipas Propozim Ndryshimit të Rregullores aktuale vendos Kryetari i Komunës dhe për shumën më të mëdha se për të cilat vendos Kryetari i Komunës, vendimin e merr Kuvendi i Komunës si organ më i lartë në Komunë.
- Po ashtu me ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje kërkohet që subjektet të cilat përfitojnë nga subvencionet, të paraqesin raportet e tyre lidhur me përmbylljen financiare të subvencioneve të pranuar për realizimin e projekteve.
- Me projektin e kësaj Rregulloreje bëhet eliminimi i dispozitave që bien ndesh me parimet themelore të përcaktuara me LVL-në përkatësisht nenin 40 pika c) dhe me ligjet tjera që rregullojnë financat publike dhe menaxhimin e tyre.

- Në kuptim të kësaj që u përmend në arsyetim të kësaj rregulloreje propozohet miratimi i saj nga anëtarët e KK-së.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi – në këtë rregullore është një ndryshim, sepse deri më tash kryetari i Komunës ka pasur të drejtë të jap subvencione deri në 2 mijë €, kurse tash është propozuar që të ketë të drejtë deri në 4 mijë.

Arijetë Rexhepi- sa i përket Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për subvencione, sipas materialit të kaluar, nëse bëhen krahasimet me rregulloren e cila është në fuqi dhe në bazë të rregullore që është në fuqi neni 6 paragrafi 2, kryetari i Komunës ka të drejtë të ndajë subvencione deri në 2 mijë €, mirëpo në bazë të rregullores e cila po kërkohet të ndryshohet dhe plotësohet është propozuar që kryetari i Komunës mund të ndajë subvencione deri në 4 mijë € për persona juridik, pra dyfish i shumës i cili është lejuar deri më tani. Gjithashtu kërkohet edhe ndryshimi i nenin 9 paragrafi 1 në të cilin thuhet se kryetari i Komunës mund t' i ndajë personave dhe familjeve në nevojë si përkujdesje materiale dhe shëndetësore, shuma e cila mund të jetë deri në 1.200€, (një mijë e dyqind), ndërsa sipas kërkesës për ndryshim, kjo shumë rritet në 1.500.€ (një mijë e pesëqind €). Në rregullore është paraparë që shuma në vlerë prej 2 mijë € të vendos KPF, pastaj t' i drejtohet KK-së. Gjithashtu është propozuar që në nenin 6 të anulohet paragrafi 4 dhe 5, prandaj unë kërkoj sqarime pse duhet të anulohen këta paragrafë. Në këtë paragrafë shkruan deri në 1 mijë € për aktivitetet e KK-së. Në bazë të këtij ndryshimi KK-së i mohohet e drejta për të bërë ndonjë aktivitet i cili është në interes të tij. Në bazë të këtyre ndryshimeve shihet qartë se kryetari i Komunës do të ketë më të lehtë menaxhimin e parasë publike në shuma më të mëdha se më parë pa pëlqimin e KPF-së, apo KK-së. Në bazë të kërkesës për ndryshim të kësaj rregulloreje a është kryetari i Komunës ai që na q na njofton për harxhimet buxhetore, por me këtë propozim ai do ta ketë më lehtë të shpërndajë para më lehtë duke ndryshuar këtë rregullore, apo ndoshta më lehtë mund të udhëtojë jashtë shtetit për pa i dhënë llogari askujt!

Grupi i LVV jemi kundër ndryshimeve që bëhen në këtë rregullore.

Jonuz Hasani- sa i përket ndryshimit të kësaj rregullore, unë personalisht e përkrahi, sepse është një çështje që duhet ta pranojmë ose t' i japim prioritet së bashku. Mirëpo unë nuk do të kisha pasur dëshirë, sepse mund edhe të ketë dyshime se ndoshta mund të ketë edhe ndonjë keqpërdorim për ndarje të subvencioneve. Këtë po e them, sepse në disa qeverisje të mëparshme janë dhënë subvencione në bujqësi si farë e grurit apo mjete bujqësore, moto kultivator etj. Prandaj duhet pasur një komision për t' i shqyrtuar ndarjen e këtyre subvencioneve dhe për t' i pas nën kontroll ndarjen e subvencioneve.

Shpresë Kurteshi- unë deshta ta njoftoj Kuvendin se ne si grup i LDK-së i kemi shqyrtuar propozimet për plotësim dhe ndryshim të kësaj rregulloreje dhe njëzëri jemi pajtuar që ta përkrahim këtë propozim.

Riad Rashiti- edhe ne si grup i anëtarëve të PDK-së jemi kundër ndryshimit dhe plotësimit të kësaj rregullore për shkak se propozohet një shumë e larët për ndarje të subvencioneve nga ana e kryetarit, pa pëlqimin e KK të Gjilanit. Unë nuk e kam qartë pse është propozuar ky ndryshim, sepse kërkesat e tilla mbi 2 mijë €, është mirë që të vijnë në KK të Gjilanit. kryetari i Komunës sa herë e merr fjalën deklaron se çdo vendim do ta sjell në Kuvend, kurse tash po shihet se me këtë ndryshim të kësaj rregulloreje në Komunën e Gjilanit po rritet edhe më shumë mos transparenca. Ne jemi kundër propozimit që kryetari të ketë të drejtë në subvencione 2 mijë dhe 4 mijë €, por edhe te propozimi prej 1 mijë e 500 € jemi kundër, sepse në KK duhet të ketë transparenca. Ky propozim më tepër është një tendencë për mbështetje të simpatizantëve dhe mbështetësve të kryetarit.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 5 e rendit të punës?

Aprovohet pika 5 e rendit të punës: Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve, me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 8 ishin kundër

5. Propozim- vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e themelimit të KKSB-së

Valentinë Bunjaku Rexhepi-për këtë pikë të rendit të punës, drejtori nuk qenka prezent, prandaj sqarime do të jep shefi i Shërbimit të Kuvendit

Sadri Arifi-është një vendim të cilin e kemi miratuar me datë 19.3.2014, kurse tash është fjala për një zëvendësim dhe një plotësim të vendimit. Zëvendësimi bëhet, sepse Zoran Kovaçević nuk ka marrë pjesë në takime të KKSB-së, kur komuniteti ortodoks e ka propozuar kandidatin tjetër Trajan Kojić. Mirëpo vendimi duhet të përfaqësohet edhe me një përfaqësues të rin nga komuniteti i krishterë, sepse në këtë KKSB duhet të enë të përfaqësuar të gjitha bashkësitë fetare. Komuniteti i krishterë e ka propozuar don Domenik Qerimin. Ky është arsyejtëmi i këtij vendimi.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 5 e rendit të punës?

Aprovohet pika 5 e rendit të punës: Propozim- vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e themelimit të KKSB-së, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

Të ndryshme

Isa Agushi- zonja kryesuese e keni dhënë fjalën se do t' i përgatiteni kartat e identitetit (bexaht), por ende nuk e keni përmbush atë premtim? E dyta as llap-topët nuk i kemi marrë i cili premtim na është dhënë para një viti. Këto janë kërkesa, por edhe premtime të cilat duhet t' i plotësoni sa më parë.

Sali Kçiku- unë shkurt do t' i përgjigjem Riadit i cili i ngriti tri çështje: sa i përket dokumenteve të prokurimit, nuk është e vërtetë atë çka e thotë Riadi, sepse unë edhe derisa kam qenë drejtor i Financave në të gjitha kërkesat që i ka bërë ia kam kthyer, por edhe në pozitën e drejtorit të Prokurimit.

Unë në pozitën e drejtorit të Prokurimit e kam thirr në zyrën time dhe aty ka qenë i pranishëm dhe e ka marrë tërë dokumentacionin dhe kopjet fizike për çdo tender për të cilin ka bërë kërkesë. Nuk e ka marrë ende vetëm përgjigjen e fundit, por edhe atë mund të vijë dhe ta merr kur të kenë kohë.

Nuk është e vërtetë që janë anuluar 18 tenderë nga OSHP, asnjë tenderë nuk është anuluar nga OSHP, por vetëm dy janë kthyer në rivlerësim dhe atë tenderi i dezinfektimit pasi që është fituar prapë operatori, sepse me kohë është njoftuar për dhënie të kontratës si dhe asfaltimi i rrugëve “Motrat Qiriazit” për të cilin komisioni për vlerësim e ka propozuar një operator ekonomik, kurse operatori tjetër nuk ka fituar, por ka bërë ankesë dhe është kthyer në rivlerësim dhe në fund nga paneli është kthyer në favor të KK.

Sa i përket tenderëve për operatorët ekonomik jashtë Komunës të cilët kanë fituar tenderë, është e vërtetë se deri më tash KK Gjilanit i ka pasur 120 aktivitete të prokurimit me vlera të mëdha të mesme, të vogla dhe minimale. Prej këtyre 120 aktiviteteve, vetëm 10 tenderë i kanë fituar kompanitë jashtë Komunës së Gjilanit, por gjashtë kompani nga Gjilani nuk kanë konkurrar fare, kanë konkurrar vetëm 4 kompani e të cilat kanë qenë me çmim më të arsyeshëm dhe me preferencë më të mirë dhe për atë iu është dhënë tenderi.

Arben Maliqi- unë propozoj pasi që jemi në fund të vitit të gjithë shefat e grupeve ta marrin fjalën dhe ta bëjnë nga një urim për festat e fund vitit.

Fehmi Sylejmani – unë mendoj se nuk kemi nevojë të nxitojmë, sepse ne sidomos në pikën nën të ndryshme po nxitojmë, kurse ne jemi të thirrur për të ngritur çështje. Unë mendoj se Viti i Ri nuk është me rëndësi a ia uron apo jo dikujt, sepse ndoshta dikush ndoshta edhe nuk e feston.

Unë i kam disa pyetje të cilat i kam adresuar në drejtoritë përkatëse. Drejtori i Shërbimeve Publike u përgjigj se e ka kthyer përgjigjen, por unë ende nuk kam marrë asnjë përgjigje.

Një pyetje përgjegjësit apo drejtorit për Rini, Kulturë dhe Sport i ka kthyer përgjigjet, por njëren pyetje nuk e ka detajizuar se cilat klube janë ndihmuar dhe me sa mjete? Për drejtorin për Financa e kam bërë një pyetje për 10 lagjet apo 10 fshatrat të cilat i kanë kryer obligimet më së shumti në Komunë, por ende nuk më ka kthyer përgjigje. Kërkoj që të keni mirëkuptim dhe të më përgjigjeni?

Riad Rashiti- do t' i përgjigjem drejtorit të prokurimit z. Kçiku dhe është mirë së paku drejtori të ketë qasje në dokumente zyrtare dhe është mirë ta lexosh veprimtarinë për të gjitha aktivitetet e zyrës sate, sepse je përgjegjës? Unë sot i kam sjell raportet me shkrim dhe është plotësisht e vërtetë se janë anuluar 18 tenderë e të cilat po t' i lexoj një nga një. E fundit është ndërtimi i Qendrës Memoriale faza e dytë, mirëmbajtja dimërore e rrugëve, furnizimi me pajisje kompjuterike, sanimi i rrugëve dhe trotuareve verore të rrugëve, asfaltimi i rrugës në lagjen “Malësia”, fshati Lladovë, Zhegër dhe shumë të tjera të cilat i lexon z. Rashiti.

Janë 14 kompani jashtë Komunës së Gjilanit të cilat kanë marrë tenderë e vlera është 1 milion e 3 mijë €. Në vijim z. Rashiti i lexon të gjitha kompanitë jashtë Gjilanit të cilat kanë fituar tenderë në Komunë të Gjilanit e të cilat kompani janë nga Prishtina, Ferizaj, Theranda, Podujeva, Kaçaniku, Deçan, etj.

Këtu janë shifrat të cilat unë i kam marrë në mënyra të tjera, sepse ju nuk jeni përgjigj asnjëherë.

Më 29.10 2014 unë e kam dërguar kërkesën e që sipas ligjit duhet brenda 7 ditëve të më përgjigjeni, unë as deri më sot nuk e kam marrë përgjigjen. Të gjitha aktivitetet e prokurimit deri në 10 mijë € i kam kërkuar, por asnjëherë nuk kam marrë përgjigje.

Sali Kçiku- sipas Riadit 18 tenderë janë anuluar nga OSHP. Nuk është vërtetë, kjo që e thotë Riadi.

Tenderët që janë kthyer në rivlerësim, janë kthyer për arsye se iu janë dhënë një operatori tjetër dhe ajo prapë do të vazhdohet. Duhet të jetë e qartë se tjetër është tenderi që është kthyer në rivlerësim, tjetër është ai që është anuluar, duhet dalluar. Sa i përket qasjeve unë po habitem dhe në seancën e kaluar gjatë pauzës i kam thënë z. Riadit që të jetë i kujdesshëm, sepse është kulturë për ta thënë të vërtetën.

Përgjigja e tij ka qenë ; “ a mos po kërkon që të lavdëroj në Kuvend”. Ka qenë Riadi në zyrën time dhe ia kam shfletuar tërë dokumentacion për të cilin ka qenë i interesuar me përjashtim të kërkesës së fundit, të gjitha kërkesat i ka marrë. Është kulturë të flitet e vërteta !

Valentinë Bunjaku Rexhepi- me kaq seanca e trembëdhjetë i përfundoi punime, kurse juve anëtarë të Kuvendit dhe pjesëmarrës të tjerë iu uroj çdo të mirë dhe suksese gjatë Vitit të Ri 2015.

Me këto debate dhe vendime, seanca e XIII i përfundoi punimet në ora 14.15 min.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesja e Kuvendit

Valentinë Bunjaku- Rexhepi